

amfALBANIA

AUTORITETI I MBIKEQYRJES FINANCIARE



'07

RAPORT VJETOR



© 2008

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa : Rruga "Perlat Rexhepi", Kati II, Tiranë

Tel : +355-4-2247148, 2250686

Faks : 355-4-2250686

E-mail : amf@amf.gov.al

URL : www.amf.gov.al

Graphic Design: Studio Grafike Elsi Kongo

Fjala Përshëndetëse e Kryetares	4
Përmbledhje e Veprimtarisë së AMF	5
PJESA I ORGANIZIMI, AKTIVITETI DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT	11
Kapitulli 1 Organizimi i AMF	
1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore	11
1.2 Menaxhimi dhe organizimi	12
1.3 Buxheti dhe financimi	19
Kapitulli 2 Aktiviteti i AMF	21
2.1 Aktiviteti rregullues	21
2.2 Aktiviteti licencues	26
2.3 Aktiviteti mbikëqyrës	32
2.4 Teknologjia e informacionit	40
2.5 Bashkëpunimi institucional	44
2.6 Marrëdhëniet me publikun, transparenca	47
Kapitulli 3 Mbrojtja e Konsumatorit	51
PJESA II TREGJET E MBIKËQYRURA - 2007	52
II.1 Tregu i sigurimeve	52
II.2 Tregu i letrave me vlerë	59
II.3 Tregu i pensioneve private suplementare	63
Shtojca	65

Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF

I nderuar lexues,

Kam kënaqësinë të sjell tek ju raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) mbi veprimtarinë dhe hapat e ndërmarrë në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare në Shqipëri në vitin 2007.

Ne filluam punën në Tetor 2006 pas bashkimit të tre autoriteteve të mëparshëm mbikëqyrës të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare. Brenda vitit 2007 organizuam dhe harmonizuam të gjitha funksionet në strukturën e re dhe arritëm të konturojmë qartë vizionin tonë të mbështetur me prioritete dhe objektiva konkrete. Gjatë vitit të kaluar ne investuam për stafin dhe krijuam një ekip aktiv që mbështeti objektivat dhe realizoi një sërë angazhimesh të marra përsipër.

Ne ndamë me Qeverinë angazhimin e përbashkët për një rregullim dhe mbikëqyrje efektive të tregjeve, për të zvogëluar ngarkesat rregullatore dhe burokracinë e panevojshme. Jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi për të krijuar standarde të mira dhe për të lehtësuar punën e operatorëve në përmbushjen e kërkesave tona, çka rrit përfitimin e tregjeve dhe konsumatorëve. Avantazhet e autoritetit të integruar po tregohen çdo ditë me funksionimin e AMF-së. Arritjet e pasqyruara në raport, janë mbështetur fort në klimën e përgjithshme pozitive, stabilitetin makroekonomik në vend dhe në zhvillimet inkurajuese të tregut të sigurimeve me hyrjen e investimeve të huaja prestigjioze në vitin 2007.

Përpjekjet e AMF u konkretizuan në harkun kohor të një viti, me miratimin e një sërë ndryshimesh dhe shtesash në kuadrin rregullativ. Përmirësimet rregullative mundësuan njëherazi përshtatjen me tendencën e lartë të zhvillimit të tregjeve financiare jobankare dhe përqasjen me kërkesat e direktivave Evropiane. Gjatë vitit 2007 zhvilluam mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve me përfshirjen e elementëve të mbikëqyrjes me bazë riskun dhe harmonizimin e tyre me sistemin tradicional të bazuar në rregulla. Gjatë një viti ne rritëm komunikimin me tregjet e mbikëqyrura, institucionet brenda e jashtë vendit dhe publikun në tërësi. Faqja jonë e internetit u shndërrua në një dritare të informacionit me një mori rubrikash të përditësuara në dispozicion të operatorëve, klientëve dhe publikut.

Asnjë nga arritjet e AMF brenda kësaj kohe të shkurtër nuk do të kishte qenë e mundur pa punën e madhe të stafit teknik të të gjitha niveleve. U jam mirënjohëse të gjithë punonjësve që kontribuan dhe jam e bindur për vazhdimësinë me të njëjtin përkushtim. Një falënderim të veçantë dëshëroj t'u përcjell kolegëve të mi të Bordit të AMF-së për angazhimin e tyre të plotë që ka ndihmuar dhe nxitur punën tonë në të gjitha drejtimet.

Shpresoj që ky raport të jetë me interes për ju.

Zj. Elisabeta GJONI

Kryetare

Përmbledhje e Veprimtarisë së AMF

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare filloi veprimtarinë e tij në Tetor të vitit 2006, duke integruar funksionet e kryera nga rregullatorët e mëparshëm në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione private suplementare. Veprimtaria e AMF-së drejtohet nga një mision qartësisht i përcaktuar: **Garantimi dhe mbrojtja e interesave të investitorëve, të siguruarve dhe publikut në tërësi.**

Në fokusin e vitit 2007 u përcaktuan si prioritete: (i) diagnostikimi i tregut, me fokus atë të sigurimeve; (ii) hartimi i një plani të plotë të zhvillimit të mbikëqyrjes; (iii) rishikimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për tregjet financiare jo-bankare dhe përshtatja e tij me direktivat Evropiane e standardet ndërkombëtare; (iv) zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të teknologjisë së informacionit me baza të dhënash të shumëfishta.

Viti 2007 mund të konsiderohet si vit i sigurimeve në Shqipëri, për zhvillimet dhe ngjarjet e veçanta që pati ky treg.

Gjatë vitit 2007, pjesa kryesore e burimeve të AMF-së u fokusua në rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu. Rishikimi i kuadrit ligjor të sigurimeve u shoqërua me hapa cilësorë që reflektuan në një masë të madhe kërkesat e direktivave Evropiane, ndërsa mbikëqyrja vijoi të forcohet me elementët e bazuar në risk dhe me një sistem të strukturuar të analizës financiare sipas modeleve bashkëkohore.

Rritja e nivelit minimal të fondit të garancisë në nivelet e përcaktuara në direktivat Evropiane ishte një ndryshim i ndjeshëm ligjor dhe në të njëjtën kohë një sfidë e sektorit të sigurimeve në vitin 2007.

Gjatë 2007, u hartuan e miratuan akte nënligjore të lidhura me (i) investimin e provigjoneve teknike dhe matematike, (ii) praktikën e trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve në sigurime, (iii) marrëveshjet e risigurimit, (iv) veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime. Këto vendime dhe rregullore, si edhe një sërë hapash rregullativë të ndërmarrë nga Bordi i AMF-së, përbëjnë hapa cilësorë në rritjen e standardeve të rregullimit të tregut të sigurimeve.

Gjatë 2007, AMF monitoroi gjendjen financiare të tregut të sigurimeve, duke përfshirë elementët e mbikëqyrjes me bazë risku dhe metoda profesionale analizuuese. Problemet e evidentuara nga analizat, ku përmenden raporti i ulët dëme/prime, shpenzimet e larta administrative dhe efektiviteti i ulët i kapitalit, u pasqyruan më tej në objektiva të veçanta të veprimtarisë së AMF-së dhe u konkretizuan në adoptimin dhe miratimin nga AMF të dokumentit të OECD-së mbi Praktikën e Mira të Trajtimit të Dëmeve në Sigurime dhe Udhëzimit mbi Vlerësimin e Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, etj.



1 vit AMF- Fjala e kryetares Zj. Elisabeta Gjoni

Në 2007, AMF në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe me mbështetjen e donatorëve të Fondit të Ballkanit Perëndimor, inicioi një projekt për zhvillimin e platformës informatike të raportimit të AMF-së. Kjo platformë elektronike e raportimit dhe analizës pritet të fillojë funksionimin brenda vitit 2008. Ajo do të garantojë komunikime të shpejta e të besueshme me operatorët, kapacitete shumë të larta të analizës, përfshirë këtu edhe paralajmërimet e hershme. Platforma të ngjashme sot funksionojnë në vendet më të zhvilluara të Evropës.

Hartimi i një metodologjie të plotë të mbikëqyrjes efektive është një projekt në proces që po realizohet me asistencën e ngushtë të Bankës Botërore.

Sigurimet e detyrueshme motorrike patën vëmendjen e veçantë të AMF-së në 2007, duke qenë që ato ende mbajtën një peshë mbi 65% në strukturën e tregut të sigurimeve. Fenomeni i shitjes nën primet e miratuara me ndikim në përkeqësimin e fi timeve, vazhdoi të përbëje një plagë të tregut shqiptar të sigurimeve. Raporti dëme/prime në sigurimin e TPL-së së brendshme mbeti ende i ulët, duke treguar një përjasje jo të drejtë të shoqërive në trajtimin dhe pagesat e dëmeve. Niveli i dëmeve është shumë larg pritshmërisë së publikut dhe nuk justifikon koston e paguar nëpërmjet primit të sigurimit.

Trajtimi i problemeve të tregut të sigurimeve të detyrueshme përfshiu (i) vlerësimin e gjendjes financiare të operatorëve dhe veçanërisht nivelin e provigjoneve teknike, (ii) inspektimet e vazhdueshme në vend mbi procesin e shitjeve dhe dëmshtëpërblymet, (iii) takimet e shpeshta me drejtuesit e shoqërive, (iv) krijimin Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik sipas kërkesave të direktivave Evropiane, (v) plotësimin e kuadrit ligjor për dëmet, investimin e provigjoneve, veprimtarinë e ndërmjetësve, etj.


AMF është aktualisht në fazën e hartimit të një projektligji të ri për sigurimet e detyrueshme, që synon përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi dhe liberalizimin gradual të çmimeve të mbështetur nga forcimi i kontrollit financiar të operatorëve.



Takim i sektorit të sigurimeve me Kryeministrin. Prill, 2007

Në 2007, AMF bashkëpunoi ngushtë me institucione të tjera në vend për shtrirjen e veprimtarisë siguroese në sektorët e ndërtimit, karburanteve, minierave dhe hotelerisë. Ky bashkëpunim mbështeti iniciativën e Qeverisë e të Kryeministrit për nxitjen e produkteve të sigurimeve që mbrojnë në masë të konsiderueshme interesat e publikut dhe të punësuarve nga rreziqet që mbart ushtrimi i aktiviteteve në sektorët e sipërpërmendur. Promovimi brenda vitit 2008 i këtyre produkteve do të sjellë njëkohësisht edhe përmirësimin e strukturës së tregut të sigurimeve.

Në 2007, AMF mbajti një dialog sistematik me tregun e sigurimeve nëpërmjet diskutimeve,



konsultimeve paraprake, trainimeve dhe formave të shpejta të komunikimit. Në faqen e internetit të AMF-së shoqëritë e sigurimeve gjejnë informacione konfidenciale të aksesueshme vetëm prej tyre, ndërsa në faqen e përbashkët mund të ballafaqojnë ecurinë e sigurimeve të detyrueshme mbi baza ditore.

Në fund të vitit 2008, shoqërive të shërbimeve financiare do t'u duhet të raportojnë pasqyrat e tyre financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Duke e parë këtë si një sfidë të madhe për sektorin e sigurimeve, AMF ka ndërmarrë nisma të trainimit të tyre me pjesëmarrjen e lektorëve ndërkombëtarë me përvojë.

Hartimi i programeve të mbrojtjes nga katastrofat mbetet një sfidë madhore për tregjet financiare në Shqipëri. AMF ka paraqitur vlerësimet e saj mbi skema kombëtare, apo rajonale të mbrojtjes financiare nga katastrofat natyrore.

Zhvillimet e vitit 2007 për tregun e sigurimeve do të mbeten veçanërisht të shënuara për përmbushjen me sukses të investimeve nga shoqëri të mëdha prestigjioze Evropiane me shoqëritë shqiptare të sigurimeve. (Në Prill - Aspis, në Korrik - Uniqa e në Gusht - TBIH).

Zhvillimet në tregun e sigurimeve nuk janë të rastësishme: qëndrueshmëria makroekonomike, zhvillimet e fundit të sektorit financiar, progresi në regjimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes të gërshetuara me potencialet e mëdha që ofron vendi, janë faktorë që kanë ndikuar në rritjen e interesit të investitorëve. Investitorë prestigjiozë janë në proces negociatash e vlerësimi për shoqëri të tjera, ndërkohë që vëmendje e madhe po i kushtohet nga tregjet ndërkombëtare privatizimit të plotë të INSIG-ut.

Megjithë peshën e madhe që ka zenë rregullimi dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit 2007 AMF ka vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të sektorëve të pensioneve dhe letrave me vlerë në Shqipëri si faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve financiare në vend.

Në sektorin e pensioneve, AMF po punon për hartimin e një projektligji të ri të pensioneve private vullnetare, që do të nxisë më tej zhvillimin e këtij sektori mbi baza të forta të garantimit dhe mbrojtjes së interesave të kontribuesve vullnetarë. Për mbikëqyrjen e tri fondeve ekzistuese, AMF ka hartuar dhe miratuar rregulla të raportimit e monitorimit.

Rregullimi i aktivitetit të pensioneve është i një rëndësie të veçantë nisur nga kohëzgjatja e përgjegjësisë të marra dhe niveli i lartë i ekspertizës që nevojitet për të menaxhuar këtë aktivitet. Referuar praktikave ndërkombëtare, janë të domosdoshme rregulla të qarta që përfshijnë profilin e mirëfilltë financiar të zotëruesve dhe më tej drejtuesve të këtyre operatorëve. Për sa më sipër dhe bazuar në rekomandimet e veçanta të FMN-së dhe angazhimet zyrtare për krijimin dhe zhvillimin e një sektori të shëndetshëm, AMF po ndjek një politikë kufizuese ndaj kërkesave për licencime, apo ndryshime që lidhen

me veprimtarinë e pensioneve private suplementare në Shqipëri. Kjo politikë shihet si domosdoshmëri deri në miratimin e rregullave të qarta sipas modeleve të suksesshme.

Hartimi i projektligjit të ri për pensionet private suplementare përbën një nga prioritetet e AMF-së për vitin 2008. Puna ka nisur në 2007 me shqyrtimin e përvojave të ndryshme të rajonit dhe marrjes së ekspertizës nga Banka Botërore. Ligji i ri do të krijojë hapësirat për zgjerimin e tregut në përmbushje edhe të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare ndaj FMN-së, për ngritjen e një sektori cilësor e aktiv të pensioneve private suplementare në Shqipëri.

AMF mbetet pjesë aktive e studimeve dhe vlerësimeve të iniciuara nga Qeveria, me qëllim reformimin e sigurimeve shoqërore dhe pensioneve.

Tregu i letrave me vlerë sot kufizohet vetëm në letrat me vlerë të Qeverisë. Gjatë 2007, AMF ndikoi në zgjerimin e tregut dytësor dhe funksionimin e rregjistrave përkatës, nëpërmjet licencimit dhe amendimeve rregullatore në kuadrin e një bashkëpunimi të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave.


AMF instaloi në faqen e internetit një sistem rating (krahasimi) GSRM, ku çdo bankë përditëson në kohë reale transaksionet dhe kuotimet për bonot e thesarit dhe obligacionet.

Interesi që është shfaqur për tregun e kapitaleve, si dhe kushtet e sotme të zhvillimit të biznesit dhe të infrastruktures institucionale, favorizojnë aktivizimin e tij.

Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e letrave me vlerë është gjithashtu në vëmendjen e AMF-së. Krahas ligjit të hartuar së fundmi nga Ministria e Financave dhe të aprovuar nga Kuvendi, AMF po punon për projektligjin e Obligacioneve të Korporatave dhe Bashkive të mbështetur nga BERZH-i dhe hartimin e projektligjit të ri mbi investimet kolektive. Këto projekte synojnë përafrimin me direktivat Evropiane dhe nxitjen e aktivizimit të tregut.

Në kryerjen e funksioneve të veta, AMF ka vlerësuar si një nga çelësat e suksesit bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira.

Gjatë 2007, AMF forcoi bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në funksion të ruajtjes dhe forcimit të stabilitetit financiar të vendit. Bashkëpunimi i ka shërbyer parandalimit të rreziqeve, rritjes së transparencës, si edhe të unifikimit të standardeve në sektorin financiar. Mjaft të efektshme kanë qenë edhe inspektimet e përbashkëta që AMF ka kryer me Bankën e Shqipërisë për çështje ku bashkëpunimi ka qenë i nevojshëm. Përsosja e teknologjisë së informacionit në të dy institucionet po mundëson një shkëmbim informacioni e komunikim më të plotë e sistematik.



AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensione (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Vlen këtu të përmendet nxitja e bashkëpunimit me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare menjëherë pas investimeve Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve dhe pensione.

Në 2007, AMF rriti komunikimin me Autoritetin Bankar Qendror të Kosovës në drejtim të shkëmbimit të përvojave reciproke, të vendosjes së standardeve dhe të organizimit të trainimeve dypalëshe. Rëndësi të veçantë pati shkëmbimi i informacioneve konfidenciale dhe kryerja e inspektimeve të përbashkëta.

Një ndër synimet tona mbetet përgatitja e profesionistëve të tregjeve financiare ku mund të përmend: vlerësuesit, aktuarët, ndërmjetësit, analistët, etj. Në vitin 2007, AMF së bashku me USAID-in, certifikuan klasën e parë të aktuarëve profesionistë në Shqipëri. Gjatë vitit 2007 AMF hartoi dy projektvendime shumë të rëndësishme në lidhje me vlerësuesit e dëmeve dhe ndërmjetësit në sigurime, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave në fillim të vitit 2008.

Transparenca jonë ka synuar informimin mbi të gjitha zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri e më gjerë, dhe ka shërbyer në të njëjtën kohë për edukimin dhe rritjen e interesit dhe besimit të konsumatorit për produktet financiare. AMF ka vënë në dispozicion të publikut faqen e plotë interaktive të internetit, publikime mujore të raporteve statistikore e periodikut dhe botime të tjera informative edukuese. Tashmë, në funksion të klientëve AMF ka vënë në dispozicion në faqen e internetit një motor kërkimi që eidenton korrektësinë e policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik.

Mbrojtja e interesave të publikut në tërësi mbështetet nga njësi e mbrojtjes së konsumatorit, ku në çdo kohë mund të dërgohen ankesat, sugjerimet apo komentet që synojnë përmirësimin e shërbimit dhe mbajtjen e premtimeve nga operatorët.

Prioritet me peshë, sidomos për vitin e parë, ishte ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve institucionale.

Modeli i integritit funksional u reflektua në strukturën organike të institucionit, që megjithëse ishte pjesë e strategjisë së krijimit, u bë e mundur të realizohet vetëm pas disa muajsh. Struktura e re siguron ndarjen e qartë të funksioneve, lehtëson unifikimin e standardeve dhe procedurave për gjithë sektorin financiar, si edhe mundëson sfidat e integritit.

AMF ka zhvilluar (me mbështetjen e FSVK-së) një strategji të burimeve njerëzore, me politika të fokusuara kryesisht në drejtim të përzgjedhjes së stafit të kualifikuar, të nxitjes dhe motivimit në punë, rritjes së kapaciteteve nëpërmjet mbështetjes për trainime

e certifikime profesionale të niveleve ndërkombëtare.

Funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, si një siguresë e institucionit, ndihmon për të evidentuar risqet dhe për të garantuar përputhshmërinë ligjore.

Gjatë këtij viti, Bordi i përbërë nga 7 anëtarë ka zhvilluar mbledhje të shpeshta për të përmbushur një sërë detyrimesh ligjore për ngritjen dhe funksionimin institucional të AMF-së, për zbatimin e shkrirjes dhe konsolidimit të tre rregullatorëve ekzistues. Njëkohësisht, bazuar në punën e vlefshme të stafit, si edhe këshillimet e Bankës Botërore, Bordi ka ndjekur me kujdes zhvillimet e tregut, duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e vëmendshme të tij. Gjatë një viti janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme rregullatore dhe funksionale.

AMF funksionon ende në ambiente zyrash jo të përshtatshme, sidomos në kushtet e aplikimit të projekteve afatgjata të teknologjisë. VKM nr. 901, datë 19.12.2007 “Për miratimin strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve, nëpunësve civil, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura” shkakton ndryshimin e tretë (rënie) të pagave të nëpunësve kryesisht të nivelit drejtues të AMFsë. Ky vendim nuk ndihmon në ruajtjen e kapaciteteve aktuale dhe ngritjen e nivelit të ekspertizës në institucion.

Hapat e hedhura në vitin 2007, për vetë kompleksitetin e fushës, shtrihen në shumë drejtime dhe konturojnë qartë një të ardhme të qëndrueshme.

PJESA I

ORGANIZIMI, AKTIVITETI DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

KAPITULLI 1

- Mbrojmë konsumatorët
- Promovojmë tregjet
- Zbatojmë ligjin

1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. AMF është institucion qëndror, i pavarur nga ekzekutivi dhe raporton në Kuvend mbi aktivitetin e ushtruar gjatë vitit paraardhës.

INSTITUCIONET nën juridiksion

- Shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës
- Brokerët dhe agjentët e sigurimeve
- Qendra e Regjistrimit të Aksioneve
- Këshilltarët e investimeve
- Shoqëritë e risigurimit
- Bursa e Tiranës
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë
- Institutet e Pensioneve Private Suplementare

Misioni

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare
- Sigurimi i respektimit të ligjit

Funksionet themelore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- tregut të sigurimeve dhe veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari,
- tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg,

- tregut të pensioneve suplementare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare, të ofruara nga institutet private të pensioneve suplementare,
- veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare jo-bankare”.

Funksionet bazë rregullative-mbikëqyrëse të AMF-së, parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe pjesërisht në ligjet e sektorëve të mbikëqyrur (Ligji nr.9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, ligji nr.8080, datë 01.03.1996, “Për Letrat me Vlerë”, ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 (i ndryshuar), “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”). Një sërë funksionesh rregullative, të përshkruara në ligjet e fushave, adresohen në mënyra të ndryshme për shkak të trashëgimisë së varësive të ndryshme të tri rregullatorëve të mëparshëm. Për këtë arsye, rishikimet në kuadrin ligjor për të përcaktuar qartë kompetencat në hartimin, propozimin e standardeve, apo akteve nënligjore, përbëjnë një proces në vijim për integrimin e plotë institucional të AMF-së.

1.2 Menaxhimi dhe organizimi

Bordi i AMF-së

Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i AMF-së është organ kolegjal, që përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve.

Të gjithë anëtarët e Bordit mandatohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afate të shkallëzuara që përcaktohen nominalisht. Bordi i AMF-së përbëhet nga:

▪ Elisabeta GJONI	<i>Kryetare</i>	▪ Miranda RAMAJ	<i>Anëtare</i>
▪ Keler GJIKA	<i>Nënkryetar</i>	▪ Saimir SALLAKU ¹	<i>Anëtar</i>
▪ Ermela GUXHOLLI	<i>Nënkryetare</i>	▪ Silvana BELLO ²	<i>Anëtare</i>
▪ Diana LAMANI	<i>Anëtare</i>		

¹ Z. Saimir Sallaku është anëtar i Bordit të AMF, që nga data 12 Prill 2007, pasi zëvendësoi në këtë funksion Zj. Raimonda Karapici.

² Zj. Silvana Bello ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion në mars të vitit 2008.

Gjatë këtij viti, Bordi i përbërë nga 7 anëtarë ka zhvilluar mbledhje të shpeshta për të përmbushur një sërë detyrimesh ligjore për ngritjen dhe funksionimin institucional të AMF-së, me shkrirjen dhe konsolidimin e tre rregullatorëve ekzistues. Njëkohësisht, bazuar në punën e stafit, si dhe këshillimet e Bankës Botërore, Bordi ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e tregut, duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e kujdesshme të tregut. Gjatë një viti janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme rregullatore, mbikëqyrëse dhe funksionale.



Bordi drejtues i AMF-së

Gjatë vitit 2007, Bordi ka zhvilluar 14 Mbledhje dhe ka marrë vendime të ndryshme në përmbushje të funksioneve rregullative, që lidhen me hartimin dhe miratimin akteve ligjore e nënligjore. Vendimet e lidhura me funksionet mbikëqyrëse përshijnë masa korrektive dhe sanksione që kanë synuar eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Vendimet e Bordit kanë trajtuar edhe anën institucionale të AMF-së dhe kanë mbështetur iniciativa të ndryshme për zhvillimin dhe promovimin e tregjeve të mbikëqyrura.

Në 2007, Bordi ka miratuar 29 akte të reja nënligjore të fushave të ndryshme, 3 amendime të rregulloreve ekzistuese, si dhe janë shqyrtuar dhe miratuar 4 akte të reja nënligjore, përkatësisht 3 projekt VKM dhe një udhëzim në fushën e sigurimeve, të cilat tashmë janë miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Kompetencat e Bordit të AMF-së

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore.
5. Miraton formatin e licencave, që lëshohen për ushtrimin e veprimtarive të mbikëqyrura nga AMF.
6. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar.
7. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.
8. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët.
9. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.
10. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u

zbatuar nga të licencuarit.

11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo-bankare.
12. Sipas ligjit, merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin.
13. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të AMF-së.
14. Merr vendime për lidhjen e memorandumëve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit.
15. Diskuton periodikisht raportet për veprimtarinë e departamenteve kryesore të Autoritetit.
16. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së.
17. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjëndjen dhe perspektivën e tregut financiar jo-bankar.
18. Miraton afatet për paraqitjen e çështjeve për shqyrtim.
19. Miraton manualët e inspektimit.
20. Përcakton politikën e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar.
21. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.
22. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e stafit.
23. Kompetenca të tjera, të parashikuara nga ligji i AMF apo nga ligjet e fushës.

Struktura organizative e AMF-së

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Bordit të AMF-së. Struktura dhe organika e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2007 u miratua me vendim të Kuvendit nr. 98, datë 30.04.2007 dhe hyri në fuqi në Shtator të vitit 2007.

Modeli i integritit funksional, u reflektua në strukturën organike të institucionit, që megjithëse ishte pjesë e strategjisë së krijimit, u bë e mundur të realizohet vetëm pas disa muajsh. Struktura e re siguron ndarjen e qartë të funksioneve, lehtëson unifikimin e standardeve dhe procedurave për gjithë sektorin financiar, për të mundur përballimin me sukses të sfidave të integritit.

AMF ka 45 punonjës, në zbatim të ligjit për ndryshimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2007, pavarësisht që Kuvendi ka miratuar një strukturë me 58 persona.

Ndërkohë, hyrja në fuqi e VKM-së nr. 901, datë 19.12.2007 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve, nëpunësve civil, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura" shkakton ndryshimin e tretë (rënie) të pagave të nëpunësve kryesisht të nivelit drejtues të


AMF-së. Kjo sjell pasoja të ndjeshme në efektivitetin e punës së drejtuesve, mbajtjen dhe tërheqjen e kapaciteteve intelektuale, gjithashtu kufizon çdo hapësirë për elemente të pavarësisë financiare të AMF-së, për më tepër që 90% e nevojave mbulohet nga të ardhurat e veta. Në përfundim, ky vendim ndikon negativisht në forcimin e AMF-së si institucion rregullator dhe mbikëqyrës i pavarur.




Struktura sipas njësive

Struktura e re e AMF-së ka katër departamente kryesore dhe disa drejtori, të cilat ndihmojnë në një ndarje më të qartë të detyrave dhe krijojnë hierarki më të përshtatshme për stafin e Autoritetit. Në funksion të organizimit të ri, Bordi i AMF-së miratoi rregulloren “Rregullat e Brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” që përcakton funksionet e veçanta dhe përgjegjësitë e departamenteve e të drejtorive, si edhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre.


Struktura sipas njësive



Struktura sipas profesionit



Struktura e stafit teknik sipas grupmoshave



Politikat e Burimeve Njerëzore

Zhvillimi i Burimeve Njerëzore në AMF konsiderohet si një proces i rëndësishëm, pasi nëpërmjet tij sigurohen marrëdhënie optimale punëdhënës-punëmarrës dhe rritet rendimenti e cilësia e punës.

AMF po zbaton strategjinë e burimeve njerëzore të hartuar në bashkëpunim me USAID, nëpërmjet FSVC-së. Kjo strategji përmban politika të fokusuara, kryesisht në drejtim të përzgjedhjes së stafit të kualifikuar, të nxitjes dhe motivimit në punë, rritjes së kapaciteteve nëpërmjet mbështetjes për trainime e certifikime profesionale të niveleve ndërkombëtare.

Megjithë krijimin e disa elementëve bazë për të zhvilluar procesin, përsëri Autoriteti ka përpara sfida të cilat kërkojnë një angazhim më të madh në periudhën 2008-2010.

Në planin afatmesëm, vëmendja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të përqëndrohet në përmirësimin e mëtejshëm të rregullave që disiplinojnë:

- nxitjen dhe motivimin e punonjësve,
- punësimin, mundësisht të më të mirëve që ofron tregu i punës,
- trajnimin e mëtejshëm të punonjësve.

Procesi i rekrutimit

Rekrutimi i specialistëve të kualifikuar, apo të sapodiplomuarve me rezultate të larta brenda dhe jashtë vendit, do të vazhdojë të jetë përparësi e politikave të burimeve njerëzore të AMF-së. Politikat e punësimit bazohen në parimin e ndërthurjes së drejtë të brezave dhe harmonizimit të përvojave të ndryshme.

Procedurat aktuale të AMF-së lejojnë një përzgjedhje transparente dhe rekrutim të elementëve të ciktuar më sipër. AMF është në proces të pandërprerë të rishikimit dhe përmirësimit të politikave të rekrutimit për të përballuar kërkesat në rritje të zhvillimit të tregjeve financiare dhe rregullimit të tyre. Kjo përjasje pasuron mjedisin profesional me përvoja të reja, që sjellin rritjen e efektivitetit në përballimin e kompleksitetit të angazhimeve.

Kualifikimi profesional

Gjatë vitit 2007, AMF i ka kushtuar vëmendje kualifikimit profesional të punonjësve sipas profileve dhe pozicioneve përkatëse. Shifrat tregojnë se në 2007, rreth 64% e stafit teknik të AMF-së ka marrë pjese aktive në seminare, trainime, të lidhura me fushat që ata mbulojnë.

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar në fushën e sigurimeve

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9228, datë 01.01.2008 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të gjitha njësitë ekonomike që operojnë në Shqipëri, përfshirë këtu edhe shoqëritë e sigurimit, kanë detyrim ligjor që të përgatisin pasqyrat financiare dhe të raportojnë sipas këtyre Standardeve në fund të vitit 2008.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Shoqatën Austriake të Siguruesve dhe kompaninë audituese KPMG, organizoi në datat 16-18 korrik 2007, seminarin me temë "Njohja dhe adaptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar në fushën e sigurimeve".

Lektorët vendas e të huaj trajtuan çështjet:

- Njohja me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, ku vëmendja kryesore u përqëndrua tek politikat kontabël (IAS 8), mënyra e hartimit të pasqyrave financiare (IAS 1), tatim mbi fitimin (IAS 12), të ardhurat (IAS 18), efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit në këto pasqyra (IAS 21), rëndësia e dhënies së informacionit me palët e lidhura (IAS 24), forma ligjore e filialeve, e shoqërive me kapital të përbashkët (IAS 27, 28, 31), investimet në aktive të qëndrueshme të trupëzuara (IAS 16 & 40), si dhe klasifikimi, matja, rënia në vlerë e instrumentave financiare (IAS 39).
- Njohja me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, rëndësia dhe mënyra e adaptimit për herë të parë e këtyre standardeve në paqyrat financiare të shoqërive të sigurimit (IFRS 1), interpretimi i kontratave të sigurimit i trajtuar sipas (IFRS 4).



Seminar mbi sistemin IFRS organizuar nga AMF në Korrik 2007



Stafi i AMF-së 2007

Janë organizuar trainime afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit, mbështetur në ekspertizën dhe asistencën e institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore, FSVK, GTZ, Këshilli i Evropës, apo shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve si IAIS, NAIC, IOPS dhe IOSCO.

Trainimet afatgjata kanë synuar përftimin e njohurive të proflizuara për fushat e objektivit të veprimtarisë së AMF-së.

Auditi i brendshëm

Funksioni

Njësia e Auditit të Brendshëm kryen funksionin e saj në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Aktiviteti

Njësia e Auditimit të Brendshëm të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2007 ka realizuar programin e miratuar nga Bordi, i cili përfshinte përfundimin e 10 auditimeve. Aktiviteti i Auditit të Brendshëm kryhet nga një specialist i auditit. Çdo procedurë auditimi është realizuar mesatarisht në 25 ditë pune.

Për specifikat e institucionit të ri siç është AMF-ja, programi i punës së auditit të brendshëm ka trajtuar aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me procedurat e bashkimit të institucioneve të mëparshme, apo me konsolidimin dhe integrimin e funksioneve brenda një institucioni të vetëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka raportuar periodikisht pranë Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, duke dhënë përkatësisht 30 rekomandime të bazuara në auditimet e kryera. Rekomandimet e dhëna janë gjetur të vlefshme dhe janë zbatuar, ose janë në proces zbatimi.

1.3 Buxheti dhe financimi

Në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare”, neni 26, AMF është institucion i pavarur, që kryesisht financohet nga burimet e veta. Buxheti i shtetit financon AMF-në në rast se shpenzimet për funksionimin normal nuk mund të përballohen nga fondet e veta. Pjesa e financimit nga buxheti i shtetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Tepricat e buxhetit të AMF-së për vitin financiar paraardhës, kalojnë në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar, me përjashtim të fondeve të destinuara për investimet që janë në proces.

AMF përgatit pasqyrat financiare dhe mban kontabilitetin në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1989 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale dhe njësive që varen prej tyre” si dhe Udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007 të Ministrisë së Financave, “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore”.

Në zbatim të neneve 26 dhe 27 të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare”, në të ardhurat e realizuara nga Autoriteti për vitin 2007 janë përfshirë të ardhurat nga tregu i sigurimeve, tregu i letrave me vlerë, tregu i pensioneve si dhe 20% e gjobave të arkëtuara.

Tabela 1: Burimi i të Ardhurave të AMF-së

<i>Burimi i të Ardhurave të AMF-së 2007</i>	<i>000 / Lekë</i>
1. Të ardhura të realizuara gjatë vitit 2007	89,673
2. Të ardhura nga financimi buxhetor	31,929
2.1 Për shpenzime funksionimi	29,990
2.2 Për investime	1,939
3. Të ardhura të trashëguara nga rezultati i mbartur për investime në proces	19,848
TOTALI	141,450

Tabela 2: Përdorimi i Fondeve të AMF-së

<i>Përdorim i Fondeve të AMF-së 2007</i>	<i>000 / Lekë</i>
1. Fonde për shpenzime funksionimi	79,307
2. Fonde për investim	45,760
2.1. Për investime të kryera	16,560
2.2. Për investime në proces	29,200
3. Derdhje sipas bilancit rezultati i vitit 2006	2,876
4. Derdhur në Buxhetin e Shtetit	13,507
TOTALI	141,450

Në strukturën e fondeve të përdorura nga AMF gjatë vitit 2007, 63% e zunë shpenzimet e funksionimit të institucionit dhe 37% fondet e investimeve të kryera e atyre në proces. Shpenzimet për punonjësit e larguar pas integritit të institucionit dhe shpenzimet për kompesime dhe detyrime gjatë vitit 2007 zunë 20% të fondit të pagave, ose 9% të totalit të shpenzimeve të funksionimit.

Gjatë vitit 2007 janë kryer dhe shpenzime për investime sipas planit financiar të miratuar. Këto investime janë fokusuar për projekte informatizimi dhe paisje zyrash, ndërsa investimet për ambjentet e zyrat janë akoma në proces, për shkak të vonesave për vënien në dispozicion të godinës. Gjatë vitit 2007 u krye procedura e tenderit për rikonstruksionin e godines, si dhe është lidhur kontrata me firmën ndërtuese.

2. Aktiviteti i AMF

2.1 Aktiviteti rregullues

Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon sektorët e mbikëqyrur ka qenë prioritet i punës së AMF-së për vitin 2007. AMF ka vlerësuar si element shumë të rëndësishëm, përjasjen me direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimeve të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian dhe përshtatjen e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve. Në hartimin e akteve nënligjore janë shqyrtuar praktika të mira të vendeve të rajonit dhe janë implementuar standarde të vendosura nga shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve.

Në fushën e sigurimeve

Ndërhyrja më e ndjeshme në kuadrin ligjor, në tregun e sigurimeve, ishte rritja e nivelit minimal të fondit të garancisë në nivelet e përcaktuara nga direktivat evropiane. Kjo rritje u realizua nëpërmjet një ndryshimi të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me **Ligjin nr. 9685, datë 26.2.2007, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”**”. Këto ndryshime konsistojnë në amendimin e nenit 98 të këtij ligji, për ndryshimin e fondit të garancisë në 3 milion Euro, proces i cili është drejt përfundimit.

VKM nr. 96, datë 03.02.2008, “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit”, projekt i miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007. Provigjonet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të rëndësishme të përgjegjësisë të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit. Rritja e cilësisë së aktiveve në mbulim të plotë të provigjoneve teknike dhe matematike i shërben synimit themelor për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. VKM është mbështetur në konkluzionet e analizave financiare të kryera nga Autoriteti për tregun e sigurimeve dhe çështjeve të evidentuara në drejtim të cilësisë së aktiveve, përjasjen me kërkesat e direktivave të Komunitetit Evropian (Direktiva e Këshillit të Evropës 92/49/EEC, datë 18.06.1992) si dhe në përvojën e vendeve të tjera Evropiane.

VKM nr. 79, datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, projekt i miratuar me vendim Bordi nr. 4, datë 30.08.2007. Plotësimi i boshllëkut ligjor në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime, ishte synimi kryesor në hartimin dhe miratimin e VKM “Për kriteret dhe procedurat e licencimit të ndërmjetësve në sigurime, rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”. Krahas rregullimit të procedurave të licencimit për aktivitetin e brokerimit, u bënë disa ndryshime edhe në kriteret për licencimin e aktivitetit

të agjentit në sigurime. Në hartimin e këtij akti është mbajtur parasysh Direktiva e Këshillit të Evropës 2002/92/EC “Për ndërmjetësimin në sigurime” si dhe disa modele të ligjeve të tjera të vendeve të BE-së.


VKM nr. 164, datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”, projekt i miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007. Vendosja e kriterëve të forta profesionale për marjen e licences, dhënia e së drejtës Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për testimin e aplikantëve rreth njohurive të tyre për fushën, kufizimi i afatit të licencës, si dhe parashikimi i rasteve të tërheqjes së saj, krijojnë premisa të mjaftueshme për të krijuar pavarësinë e nevojshme të vlerësuesit nga shoqëria dhe rritjen e objektivitetit në procesin e vlerësimit të dëmeve. Për të pasur një projekt sa më bashkëkohor, VKM është bazuar në parimet e IAIS dhe praktikën e legjislacionit të disa vendeve të BE-së. Në procesin e hartimit të projektvendimit është tërhequr mendimi i të gjithë aktorëve të tregut dhe palëve të tjera të interesuara.

Udhëzimi nr. 24, datë 15.11.2007 “Për administrimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” i Ministrisë së Financave. Ky udhëzim trajton dëmet pasurore dhe jopasurore të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, vlerësimin e dëmit dhe mënyrat e afatit e likuidimit dhe kontabilizimit të dëmeve.

Udhëzim “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”, miratuar me vendim Bordi nr. 6, datë 30.08.2007. Ky udhëzim është mbështetur në materialin standard të OECD-së “Udhëzimet e OECD-së për administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”. Administrimi i mirë i dëmeve ka qenë shqetësim prioritar për AMF-në dhe ky udhëzues është i rëndësishëm për mbrojtjen e policëmbajtësve, përfituesve apo palëve të treta. Në të njëjtën kohë dhe për shoqëritë e sigurimit përbën një element kyç në konkurrencën mes ofruesve të sigurimit dhe përmirësimit të imazhit publik të vetë industrisë.

Rregullore “Për kriteret e risigurimit”, miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 18.06.2007. Rregullorja shfuqizoi atë ekzistuese për kriteret e risigurimit duke sjellë përmirësim të dukshëm cilësor. Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë parasysh standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrjes në Sigurime, kushtet aktuale në të cilat gjenden shoqëritë e sigurimit, por njëkohësisht janë vënë kriteret, të cilat përcaktojnë edhe kërkesat minimale për risiguruesit si qëndrueshmëria financiare, operacionale, me qëllim ruajtjen e një tregu sigurimesh të stabilizuar.

Ndryshime në rregulloren “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”, ndryshime të miratuara me vendimin e Bordit nr. 10, datë 17.12.2007. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabël të jetë jo më gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj. Në hartimin e këtyre ndryshimeve u mbajt parasysh



eksperienca e disa vendeve të BE. Bazuar në parimet e IAIS parashikohet që të ketë një afat kohor që shoqëritë e ekspertëve kontabël të kryejnë auditimin në shoqëritë e sigurimit.

Rregullore “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 3, date 3.10.2007. Rregjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike përbën një platformë raportimi dhe identifikimi të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar. Ky Rregjistër do të plotësojë dhe përmirësojë kërkesat e AMF për raportim, si dhe nevojat e tregut për një proces më të sigurtë, më të formalizuar dhe më të përshtatshëm të shitjes së policave. Në aspektin afatgjatë Rregjistri do të plotësohet me të dhëna për dëmet në sigurimet e detyrueshme motorrike, si dhe do të sigurohet lidhje online me bazat e të dhënave të aksidenteve, identifikimit të personave, dhe të mjeteve, përkatësisht me Ministrinë e Brendshme dhe atë të Transportit. Platforma të ngjashme mund të përmendim TRAMER në Turqi nga e cila ky projekt ka trashëguar mjaft karakteristika.

Në fushën e letrave me vlerë

Ndryshime në rregulloren “Mbi tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH-së”, të miratuara me vendimin e Bordit nr. 2, datë 30.10.2007. Ndryshimet në këtë rregullore kanë patur si qëllim përmirësimin e kuadrit rregullativ të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe mbrojtjen më të mirë të konsumatorit. Ato kanë sjellë përmirësimin e mënyrës së funksionimit dhe përdorimit të sistemit GSRM nga subjektet e licencuara. Nëpërmjet këtij sistemi subjektet e licencuara publikojnë të dhëna mbi kuotimet dhe transaksionet e kryera në tregun me pakicë të këtyre instrumenteve. Publikimi i të dhënave rrit transparencën për publikun investitor dhe ndikon në uljen e kostove operacionale të këtij tregu.

Në fushën e pensioneve private

Ndryshime në rregulloren “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare”, të miratuara me vendimin e Bordit nr. 3, datë 21.11.2007. Amendimi i rregullores në fuqi konsiston në përmirësimin dhe amendimin e neneve që lidhen me objektin, procedurën, përmbajtjen e raportit të inspektimit, etikën gjatë kryerjes së inspektimit dhe format e kontrollit/inspektimit. Rregullorja e amenduar, përshkruan me detaje detyrat e Drejtorisë së Raportimit dhe Analizës, në kuadrin e kryerjes së mbikëqyrjes mbi dokumenta (off-site) të instituteve private të pensioneve suplementare. Rregullorja përfshin për herë të parë llogaritjen e çartë të aftësisë paguese dhe aktivet e përshtatshme në mbulim të saj. Ajo pasqyron kërkesat e Direktivave Evropiane 2003/41/EC, datë 03/06/2003 dhe 2002/83/EC, datë 19/12/2002.

Të tjera

Udhëzim “Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit”, miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 3.10.2007. Ky udhëzim përmban rregullat e shpërndarjes dhe sigurisë së informacionit, që përcaktojnë procedurat e mirëorganizimit të institucionit dhe lehtësojnë komunikimin ndërmjet strukturave. Udhëzimi mundëson infrastrukturën për përcaktimin e informacionit elektronik, si dhe për krijimin e regjistrit online elektronik të sigurimeve të detyrueshme motorrike.

Udhëzim “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare”, miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 21.11.2007. Hartimi i këtij udhëzimi synoi vendosjen e rregullave dhe procedurave mbi mënyrën e komunikimit, etikën profesionale dhe disiplinën që duhet të shoqërojë procesin e inspektimit në vend në subjektet financiare jo-bankare.

Rregullore “Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 7, datë 30.8.2007.

Plani për ndryshimet ligjore

Zbatimi i angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në të tre fushat: të sigurimeve, letrave me vlerë dhe të pensioneve private suplementare.

Hartimi i projektligjit të ri, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, do të sjellë një rregullim të mëtejshëm të tregut dhe të plotësojë vakumin ligjor ekzistues. Projektligji synon të zgjerojë gamën e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, të përmirësojë arkitekturën institucionale, të forcojë rolin mbikëqyrës të AMF-së, si dhe përafrimin me direktivat evropiane.

Po vijon puna në përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e letrave me vlerë, ku vlen të përmenden projektet mbi Obligacionet e Koorporatave dhe Bashkive të mbështetur nga BERZH-i, si dhe hartimi i projektligjit të ri mbi investimet kolektive.

Në proces është edhe projektligji “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në përputhje me reformën kombëtare të Qeverisë në fushën e pensioneve.

Akte ligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2007

Në fushën e sigurimeve

1. VKM nr. 96, datë 03.02.2008, "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit", projekti i miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007.
2. VKM nr. 164, datë 28.01.2008, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime", projekti i miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007.
3. VKM nr. 79, datë 03.02.2008, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës", projekti i miratuar me vendim Bordi nr. 4, datë 30.08.2007.
4. Udhëzimi nr. 24, datë 15.11.2007 "Për administrimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta" i Ministrit të Financave.
5. Rregullore "Për kriteret e risigurimit", miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 18.06.2007.
6. Rregullore "Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm", miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 3.10.2007.
7. Udhëzim "Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime", miratuar me vendim Bordi nr. 6, datë 30.08.2007.
8. Ndryshime në rregulloren "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit", ndryshime të miratuara me vendim Bordi nr. 10, datë 17.12.2007.

Në fushën e letrave e vlerë

9. Ndryshime në rregulloren "Mbi tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH-së", ndryshime të miratuara me vendim Bordi nr. 2, datë 30.10.2007.

Në fushën e pensioneve private

10. Ndryshime në rregulloren "Për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar të instituteve private të pensioneve suplementare", ndryshime të miratuara me vendim Bordi nr. 3, datë 21.11.2007.

Të tjera

11. Rregullore "Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", miratuar me vendim Bordi nr. 7, datë 30.8.2007.
12. Udhëzim "Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit", miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 3.10.2007.
13. Udhëzim "Për procedurat e inspektimit në subjektet financiarë jo-bankarë", miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 21.11.2007.

2.2 Aktiviteti licencues

Kriteret e licencimit të përcaktuara në ligjet e fushës, si dhe në aktet nënligjore për aktivitetet nën juridiksion të AMF-së, synojnë në sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Nëpërmjet arritjes së një procedure licencimi efektive e të paanshme, rritet besimi në sistemin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare si dhe bëhet i mundur liberalizimi i mëtejshëm i aksesimit të këtyre tregjeve nga investitorë të huaj. Kriteret dhe kushtet e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun shqiptar të sigurimeve, dëshmon politikën e hapur të AMF-së ndaj investimeve të huaja, pa cënuar kërkesat ligjore. Lëvizja e lirë e kapitalit dhe hapësira për të ofruar shërbime janë dy objektiva themelore që po shoqërohen edhe me ndryshimet ligjore përkatëse në fushën e licencimit. Një tjetër objektivi i rëndësishëm në politikën e licencimit është forcimi i kriterëve “fit and proper”, për personat që ushtrojnë funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës, drejtuesit, aksionerit me pjesëmarrje influencuese, aktuarit apo anëtarit të auditit të brendshëm. Kjo do të thotë që këta persona të disponojnë integritetin, kompetencat, eksperiencën dhe kualifikimet e duhura për të përmbushur këtë detyrë.

Aktiviteti licencues në sigurime

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Autoriteti i është përgjigjur në kohë, me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri kërkesave të paraqitura nga subjektet në tregun e sigurimeve për licencim, zgjerim aktiviteti, apo miratim të transaksioneve që lidhen me ndryshime në kapitalin aksioner.

Rritja e Fondit të Garancisë për shoqëritë e sigurimeve

Një nga zhvillimet pozitive në tregun e sigurimeve, ka qenë rritja e fondit të garancisë për shoqëritë e sigurimit, në zbatim të detyrimit ligjor, parashikuar në Ligjin nr. 9685, datë 26.02.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”.

Gjatë vitit 2007, shoqëritë e sigurimit kanë plotësuar 2 fazat e para të plotësimit të detyrimit ligjor për rritjen e fondit të garancisë, faza të cilat janë ndjekur me kujdes nga AMF, për respektimin e afateve ligjore dhe analizës së informacionit për burimin e kapitalit në mbështetje të kërkesave ligjore. Të gjitha shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës, plotësuan kapitalin me transaksione të cilat u miratuan nga Bordi i AMF-së, pas një bashkëpunimi të mirë institucional dhe komunikimi të vazhdueshëm me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave për burimin e kapitalit. Faza e tretë dhe e fundit për plotësimin e fondit të garancisë është data 31 Mars 2008.


Investimet e huaja në tregun e sigurimeve

Hyrja e kapitalit të huaj është një risi për tregun shqiptar të sigurimeve, që dëshmon se ky sektor është me potenciale të mëdha zhvillimi dhe tërheqës për investitorët e huaj. Futja në tregun e sigurimeve e emrave të njohur si UNIQA Group Austria, Vienna Insurance Group dhe ASPIS Group do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së tregut të sigurimeve, rritjen e gamës së produkteve, si dhe menaxhimit më të specializuar të shoqërive.

Investime të huaja 2007

- Pjesëmarrja influencuese e shoqërisë “Aspis Holdings Public Company Ltd” në shoqërinë e sigurimit “Interalbanian” sh.a në masën 51%, prill 2007.
- Pjesëmarrja influencuese e shoqërisë “TBIH Financial Services Group N.V Amsterdam”, (ku Vienna Insurance Group zoteron 60% të kapitalit) në shoqërinë e sigurimit “Sigma” sh.a në masën 75%+1, gusht 2007.
- Prezenca e shoqërisë “UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH” Austri, në shoqërinë e sigurimit “Sigal” sh.a dhe “Sigal-life” sh.a, korrik 2007. Në janar 2008, pjesëmarrja influencuese e shoqërisë “UNIQA”, në masën 45.62% në shoqërinë “Sigal Holding” sh.a (zotëruese e kapitalit të shoqërisë “Sigal” sh.a dhe “Sigal-life” sh.a).

Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës - 2007



Licencimi i ndërmjetësve në sigurime

Shitja e policave të sigurimit nga agjentë të licencuar apo punonjës të shoqërisë, ka qenë kërkesë e vazhdueshme e AMF-së gjatë vitit 2007, në zbatim të kërkesave ligjore. Ndjekja

e politikave të qarta dhe zbatimi i kriterëve të licencimit për agjentët në sigurime kanë ndikuar drejt një procesi progresiv në shitjen e policave të sigurimit, proces i cili ende kërkon përpjekje.

Gjatë vitit 2007 AMF licenoi 86 agjentë të sigurimit të jo-jetës, në vijim të aplikimeve të kryera prej shoqërive të sigurimit. Licenca për agjent në sigurime është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare dhe me të drejtë rinovimi. Vlefshmëria e licencës fillon pas lidhjes së kontratës me shoqërinë e sigurimit dhe instalimit të programit të shitjes on-line për policat e sigurimit të detyrueshëm.

Mosplotësimi i kriterëve të licencimit nga disa aplikantë, veçanërisht në mosplotësim të kriterëve të besueshmërisë, solli katër raste refuzimi në dhënien e licencës për veprimtari agjenti në sigurime.

Veprimtaria e brokerimit në sigurime nuk është ende prezente në tregun shqiptar të sigurimeve. Gjatë vitit 2007, pati shprehje të interesit nga subjekte brenda dhe jashtë vendit për këtë veprimtari. Ndërkohë, u punua për përcaktimin e rregullave të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për këtë kategori.

Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë mbizotërohet nga letrat me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione afatgjata). Tregu i aksioneve dhe obligacioneve të shoqërive tregtare mbetet ende i pazhvilluar.

Në tregun e bonove të thesarit vihet re tendenca e rritjes së pjesëmarrjes së individëve. Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve individëve apo persona juridikë shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individë me 80.25% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2007 u dominua në masën 94.60% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 5.40% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Tendenca tjetër është rritja e peshës së obligacioneve afatgjata në totalin e portofolit të obligacioneve. Ndryshimi i strukturës është në favor të obligacioneve afatgjata, ato 3 dhe 5 vjeçare, në krahasim me ato 2 vjeçare, krahasuar me fundin e vitit 2006. Në fillim të dhjetorit 2007 u emetuan për herë të parë obligacionet me afat 7 vjeçar.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i është përgjigjur në kohë dhe me cilësi edhe kërkesave të operatorëve të tregut të letrave me vlerë. Interesi i shprehur nga Posta Shqiptare dhe shoqëria e re "Kapital-Invest" u finalizuan me licencimin e tyre si tregtarë në tregun e

letrave me vlerë, duke rritur numrin e operatorëve në këtë treg, kryesisht në tregtimin e letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - rregullator i tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara, për kryerjen e transaksioneve me investitorët të cilët mund të jenë, persona fizikë ose juridikë, rezidentë dhe jorezidentë.

Ndërmarrja e veprimtarisë së tregtimit në tregun me pakicë dhe e mbajtjes së regjistrimit analitik bëhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Mbajtja e regjistrimit analitik përbën kusht për licencimin e tregtarit të letrave me vlerë të Qeverisë që do të operojë në tregun me pakicë.

Rregjistrimi siguron mbajtjen e të dhënave në mënyrë analitike për investitorët mbi pronësinë e letrave me vlerë të Qeverisë, transaksionet e kryera në lidhje me këto letra me vlerë apo të dhëna në lidhje me vendosjen e tyre si garanci.

Në prill 2007, u miratua Licenca e shoqërisë “Kapital-Invest” sh.a për të operuar si tregtar i letrave me vlerë në Bursë dhe në tregun me pakicë për letrat me vlerë të Qeverisë për një periudhë pa afat. Njëkohësisht, u miratua licenca për përfaqësuesin tregtar të kësaj shoqërie.

Po në prill 2007, u miratua licenca e shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a për të operuar si tregtar në tregun me pakicë vetëm për bono thesari në sportelet e saj në 14 filialet.

Në lidhje me operatorët e tregut të letrave me vlerë pati dhe disa zhvillime që u lidhën me miratime për dy zgjerime të objektit të licencës, tre zgjatje të afatit dhe dy ndryshime statuti.

Zhvillime në tregun e letrave me vlerë

- Zgjerimi i objektit të licencës të shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a, si regjistruar edhe për Obligacionet e Qeverisë të Republikës së Shqipërisë - janar 2007
- Zgjerimi i objektit të licencës shoqërisë “Alpha Bank” si regjistruar edhe për Obligacionet e Qeverisë të Republikës së Shqipërisë - maj 2007
- Zgjatja e afatit të licencës për 2 përfaqësuesit si tregëtarë në letrat me vlerë për shoqërinë “Banka Tregtare Kombëtare” - prill 2007
- Zgjatja e afatit të licencës për 2 përfaqësuesit si tregëtarë në letrat me vlerë për shoqërinë “Banka Amerikane e Shqipërisë” - dhjetor 2007
- Zgjatja e afatit të licencës të shoqërisë aksionere “Bursa e Tiranës” sh.a, si treg letrash me vlerë me afat të pacaktuar - korrik 2007
- Ndryshime në statutin e shoqërisë “Bursa e Tiranës” sh.a - gusht 2007
- Ndryshimi në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Bursa e Tiranës” sh.a - tetor 2007.

Ekzistenca dhe zhvillimi i tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë ngjalli interes tek shumë subjekte brenda dhe jashtë vendit, të cilët shprehën interes për t'u bërë pjesëmarrës të këtij tregu. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim pati bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave për zgjerimin e tregut, edukimin e publikut, rritjen e transparencës në treg, si dhe dialogu i vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë në lidhje me tregtimin me pakicë. Komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun i ka shërbyer vënia në funksionim e sistemit GSRM.

Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve private

Zhvillimet në tregun e pensioneve private kanë qenë më pak të ndjeshme. Ky treg mbetet një treg i ri, që dominohet nga problemet e nisjes.

Në mbështetje të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 (i ndryshuar) "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve" dhe akteve nënligjore, janë licencuar 3 shoqëri që ushtrojnë aktivitetin në tregun privat të pensioneve suplementare, si më poshtë:

- Shoqëria "GARANTSIG" – Institut Privat Pensionesh
- Shoqëria "IAPPSSH" – Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë
- Shoqëria "CAPITAL" – Institut Privat Pensionesh

Kuadri ligjor ekzistues paraqet mangësi të theksuara në drejtim të kërkesave të licencimit, të standardeve 'fit & proper' në qeverisje, të politikave të investimeve dhe elementëve të mbikëqyrjes. Këto mangësi kanë diktuar edhe mbajtjen pezull të kryerjes së procedurave të lidhura me licencime apo ndryshime, deri në përmirësimin e kuadrit ligjor, sanksionuar kjo edhe në Memorandumin e nënshkruar mes Qeverisë shqiptare dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar "Mbi Politikën ekonomike dhe financiare të Shqipërisë".

Në kushtet e një kuadri ligjor jo të plotë, nën këshillimet e FMN-së dhe Bankës Botërore, AMF ka ndjekur politika të kujdesshme për trajtimin e shoqërive ekzistuese dhe shqyrtimin e shprehjes së interesit nga subjekte të ndryshme për licencime, apo ndryshime brenda këtij lloji aktiviteti. Për këto arsye, numri i pjesëmarrësve në tregun e pensioneve private mbeti i kufi zuar. AMF ka monitoruar e administruar me kujdes lëvizjen në shoqëritë ekzistuese, me qëllim ruajtjen e interesave të aderuesve.

Qeverisja e shoqërive aksionere

Kuadri rregullativ mbi qeverisjen e shoqërive aksionere, sipas parimeve të OECD duhet të promovojë tregje transparente dhe efiçente, të jetë në përputhje me dispozitat ligjore

në fuqi dhe të ndajë qartë përgjegjësitë midis aksionerëve, administratorëve dhe autoriteteve të ndryshme rregullatore e mbikëqyrëse.

Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, AMF ka respektuar kriteret për të zgjedhurit në këshillat mbikëqyrës, në postet drejtuese apo komitetet e kontrollit. Në të njëjtën kohë, AMF ka tentuar të nxisë rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit, brenda kufizimeve dhe mungesave të theksuara të ligjeve ekzistuese. Gjatë vitit 2007 janë realizuar dy miratime për drejtorë të përgjithshëm të shoqërive të sigurimit dhe tre miratime për anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit.

Struktura aktuale



Qeverisja e shoqërive të sigurimit – statistika

- Numri mesatar i aksionerëve është 6
- Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 5
- Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionerë është 2
- Numri i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese është 3

Tabela 3: Të dhëna për aksionerët

Emërtimi	Numri
Shoqëri sigurimi	10
Aksionerë gjithsej	52
Me pjesëmarrje zotëruese si më poshtë:	
nën 10%	29
mbi 10% nën 20%	8
mbi 20% nën 33 %	7
mbi 33% nën 50%	2
mbi 50%	6
Aksionerë të huaj	5
Aksionerë vendas	47
Aksionerë si individë	45
Aksionerë si shoqëri	6
Aksionerë shteti	1

Mbikëqyrja tradicionale

- Garanton sigurinë e institucioneve financiare nëpërmjet vendosjes së rregullave
- Rregullat janë të zbatueshme për të gjitha institucionet financiare dhe përcaktohen me ligj
- Vendosje e sanksioneve në funksion të zbatimit të rregullave

Mbikëqyrja me bazë riskun

- Vlerëson biznesin e një kompanie, profi lin e riskut dhe kontekstin makro-ekonomik në dy dimensione:
 - a. Profilin individuale të risqeve
 - b. Riskun sistematik
- Analizon ndikimin që një falimentim i mundshëm mund të ketë kundrejt:
 - a. Policëmbajtësve
 - b. Sistemit financiar
- Dizenjon një sistem efektiv mbikëqyrës

Avantazhet

- Menaxhim risku më i mirë
- Treg më eficient
- Efekte pozitive ekonomike edhe në nivel makro

Sfidat

- Kërkon më shumë eksperiencë dhe aftësi sesa modeli tradicional i bazuar në rregulla
- Hartimi i metodologjive të sofistikuara (manuale të brendshme, trainime, etj.)
- Pranimi dhe adoptimi i metodologjive nga stafi mbikëqyrës
- Modeli i bazuar mbi gjykimin i cili mund të mos jetë gjithmonë objektiv
- Gjykim mbikëqyrës mund të sfidohet nga institucionet financiare - vështirësi për të provuar saktësinë nga secila palë
- Modeli tërësisht i bazuar në gjykim vështirëson fazat e ndërhyrjes nga ana e Mbikëqyrjes

2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Funksioni themelor i mbikëqyrjes është mbrojtja e konsumatorit, me qëllim përmbushjen në të gjitha rrethanat, të angazhimeve apo detyrimeve që shoqëritë e sigurimit kanë ndaj policëmbajtësve. AMF monitoron në mënyrë të vazhdueshme përgjegjësitë e marra nga shoqëritë e sigurimit dhe verifikon me anë të parametrave financiarë e teknikë, burimet e mjaftueshme dhe formën për përballimin e këtyre përgjegjësisve. Ngritja e një sistemi raportimi periodik, siguron një bazë të dhënash për përgjegjësitë e marra nga ana e shoqërive. Analizimi i raportimeve, si dhe verifikimet në vend nëpërmjet inspektimeve, prodhojnë parametrat financiarë dhe teknikë të mjeteve që shoqëritë duhet të kenë në dispozicion, si dhe mënyrën e administrimit të tyre, në mënyrë që shoqëritë e sigurimit të jenë në gjendje të përballojnë përgjegjësitë e ndërmarra.

Viti 2007, ishte një vit i veçantë në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve. Brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore shoqëritë e sigurimit duhet të dispononin kapital minimal në formën e fondit të garancisë në nivelet e vendeve të BE-së. Kështu Fondi i Garancisë si për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe ato të jo-jetës duhet të jetë në masën 370 mln lekë. Për vetë karakteristikat e ambientit të sigurimeve në Shqipëri dhe afateve të ngushta në arritjen e këtij niveli minimal kapitali, kryesisht mënyra e vetme ka qenë injektimi i kapitalit nga aksionerët e shoqërive. I gjithë procesi i rritjes së kapitalit në të gjitha format e përzgjedhura nga shoqëritë e sigurimit është ndjekur me përparësi nga AMF, ku dhe janë mbyllur me sukses dy transhet e para të këtij procesi. Transhi i tretë dhe i fundit për plotësimin e Fondit të Garancisë është data 31 Mars 2008.

AMF po ndërmerr aktivitete për të përmirësuar proceset e mbikëqyrjes dhe për t'i përshtatur me bazë risku për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Kalimi nga metoda tradicionale në këtë përqasje të re kërkon të mbështetet nga një sistem elektronik bashkëkohor i raportimit dhe analizës.

Bordi i drejtorëve të BERZH-it miratoi projektin e zhvillimit të sistemit informatik të raportimit të AMF-së për sigurimet e pensionet, i cili në 7 dhjetor 2007 u mbështet unanimisht edhe nga donatorët e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Ngritja e një platforme të tillë informatike do të garantojë një komunikim të shpejtë e të besueshëm, kapacitete shumë të larta të analizës, si dhe paralajmërime të hershme, si element shumë i rëndësishëm i mbikëqyrjes. Platforma të tilla përdoren sot në vende të zhvilluara të Bashkimit Evropian. Gjithashtu AMF po bashkëpunon ngushtë me Bankën Botërore për realizimin e projektit të hartimit të metodologjisë së plotë të mbikëqyrjes efektive me bazë riskun, që do t'i ketë rezultatet e saj në vitin e ardhshëm.

AMF e kryen funksionin e saj të mbikëqyrjes së tregjeve përmes analizimit të dokumentave (kontrolli dokumentar "off site") të raportuara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe ndërrmarjes së inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura (inspektimi në vend "on site").

Inspektimi dokumentar (off site) kryesisht bazohet në analizimin e pasqyrave periodike, teknike e financiare, të depozituara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe çfarëdo dokumentacioni të kërkuar me ligj. Nëse nga analizimi i pasqyrave vihen re parregullsi apo mangësi, AMF reagon përkatësisht për eliminimin e shkeljeve.

Inspektimi në vend (on site) mund të jetë i planifikuar apo ad hoc, por mund të jetë i lidhur dhe me sinjalet e ndryshme apo ankesat, në lidhje me aktivitetin e subjekteve të mbikëqyrura.

Kontrolli në vend dhe ai dokumentar mund të përfshijnë një tematikë të gjerë, ose mund të fokusohen në çështje të veçanta.

Sistemi elektronik i manaxhimit të informacionit (SMI)

Projekt në bashkëpunim me BERZH-in

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me mbështetjen e donatorëve të Fondit të Ballkanit Perëndimor, ka mbështetur AMF-në me projektin e Zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI).

Objektivi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit të informacionit që mbështet proceset mbikëqyrëse të AMF-së. Projekti i shërben zhvillimit efektiv dhe konform rregullave të tregjeve financiare jo-bankare, përfshirë këtu sektorin e sigurimeve (jetë dhe jo-jetë) dhe administrimin e fondeve të pensioneve, duke rritur rolin e AMF-së, nëpërmjet modernizimit të sistemit të tij të informacionit dhe raportimit.

Ky sistem përdoret për funksionet e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave dhe mundëson evidentimin e problemeve, duke i shërbyer AMF-së në të njëjtën kohë për kalimin tek përqasja e mbikëqyrjes "me bazë riskun" dhe përdorimi me efektivitet i burimeve të mbikëqyrjes. Zbatimi ndihmon në monitorimin nga afër të aftësisë paguese dhe aspekteve të tjera të shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensioneve. SMI do të fokusohet në shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve, duke lënë hapësira për shtrirje në sektorin e mbikëqyrjes së shoqërive të letrave me vlerë, apo operatorëve të tjerë të mbikëqyrur (si ndërmjetësit) në të ardhmen.

Projekti është në proces, ndërsa sistemi pritet të fillojë funksionimin brenda vitit 2008.

Meqënëse tregu i sigurimeve dominon sektorin jo-bankar, një prej prioritetëve të AMF-së është arritja e një mbikëqyrje efektive të shoqërive të sigurimit. Në këtë aspekt, një sërë reformash të rëndësishme ligjore janë ndërmarrë me qëllim përforcimin e mbikëqyrjes së këtij tregu. Ndër aktet ligjore më të rëndësishme dhe me efekt të drejtpërdrejtë mund të përmendim:

Udhëzim “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo bankare”

AMF në vitin 2007 hartoi aktin nën ligjor, Udhëzim i AMF nr 3, datë 21.11.2007 “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo bankare”. Ky udhëzim kishte për qëllim përcaktimin e rregullave, udhëzimeve, procedurave gjatë inspektimit në subjektet financiare jo bankare, procedura të komunikimit, rregulla të etikës profesionale dhe disiplinës që duhet të zbatohen gjatë ushtrimit të inspektimit on site.

- VKM nr. 96, datë 03.02.2008, “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit”, projekt i miratuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007.
- Rregullorja “Për kriteret e risigurimit”, projekt i miratuar me vendim Bordi nr. 2, datë 18.06.2007.
- Ndryshime në rregulloren “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”, ndryshime të miratuara me vendimin e Bordit nr. 10, datë 17.12.2007.

Analiza financiare e sektorit të sigurimeve (off site)

Autoriteti ka monitoruar pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit, mbështetur në bazën ligjore në fuqi. Procesi është përqëndruar si në monitorimin e procesit të raportimit të saktë dhe në kohë të këtyre pasqyrave, ashtu edhe në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2007.

Struktura e tregut të sigurimeve edhe gjatë vitit 2007 vazhdon të përbëhet nga 10 shoqëri sigurimesh nga të cilat 7 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jo-jetës, dy në sigurimet e jetës dhe një në sigurimet e jo-jetës dhe jetës së bashku.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” në banka të nivelit të dytë me afat 1- vjeçar dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit.

Nga analiza e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2007, vërehen keto tendenca:

- Totali i aktiveve të tregut të sigurimit arriti në vlerën 13.3 mld lekë, nga 11.4 mld lekë që ishte në 31.12.2006, duke shënuar një rritje në masën 16.65%. Kjo rritje është reflektuar kryesisht në investime në depozita.
- Zëri Debitor mbetet ende i lartë duke arritur vlerën 1.2 mld lekë ose 9.04% të totalit të

aktiveve të tregut.

- Depozitat me afat në banka arritën në vlerën 4.9 mld lekë në 31.12.2007, duke pësuar një rritje prej 1.6 mld lekë në krahasim me 31.12.2006 dhe duke përbërë zërin më të lartë të aktiveve të tregut në masën 36.40% të totalit të aktiveve. Rritja në zërin e depozitave vjen si pasojë e derdhjes në bankat e nivelit të dytë të transhit të dytë të Fondit të Garancisë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Autoriteti ka verifikuar në fund të çdo tremujori, marzhin e aftësisë paguese, aftësinë aktuale paguese (kapitalin) dhe investimin e tij. Aftësia aktuale paguese e tregut me 31.12.2007 është në vlerën 4.5 mld lekë nga 3.4 mld lekë që ishte më 31.12.2006.

Tabela 4: Bilanci kontabël i tregut të sigurimeve

<i>Bilanci Kontabël i Tregut të Sigurimeve</i>	<i>31.12.2006</i>	<i>31.12.2007</i>
Depozita	3,233,330,690	4,863,415,593
Toka dhe ndërtime	1,014,052,682	1,000,950,877
Aksione dhe pjesëmarrje	949,907,019	1,107,854,370
Bono Thesari	2,359,279,103	1,899,747,685
Debitorë	1,120,486,922	1,207,280,500
Aktive të tjera	2,775,875,033	3,280,801,970
TOTALI I AKTIVIT	11,452,931,448	13,360,050,995
Provizjonet teknike bruto	5,518,078,451	5,929,452,945
Detyrime të tjera	377,560,432	474,429,436
Kapitalet e veta	5,557,292,565	6,956,168,615
TOTALI PASIVIT	11,452,931,448	13,360,050,995

Treguesit financiarë IRIS³

Autoriteti, gjatë vitit 2007, ka përfshirë në sistemin e tij të analizës metoda të mbikëqyrjes me bazë risku, të implementuara për herë të parë në fund të vitit 2006. Në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve janë përdorur treguesit e sistemit IRIS të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës në Shqipëri. Këta tregues financiarë, përfshijnë elemente të paralajmërimeve të hershme (early warning), në lidhje me situata të pakëndshme me të cilat mund të përballen shoqëritë e sigurimit. Evidentimi në kohë i problemeve bën të mundur gjetjen e mënyrave për korrektimin apo shmangien e këtyre situatave dhe shërben si mjet efikas për mbrojtjen e interesave të klientëve dhe publikut në tërësi.

Raporti i mbajtjes neto është relativisht i lartë në kuadër tregu. Norma e lartë e mbajtjes është e lidhur me strukturën e sigurimeve në Shqipëri, ku dominon sigurimi i TPL-së së brendshme, që ndikon në normën e lartë të mbajtjes nga shoqëritë.

³ Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve

Raporti dëme/prime në nivel tregu, vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulta, rreth 24.19%. Ky raport është në masën 25.87% për tregun e jo-jetës dhe 3.74% për tregun e jetës.

Raporti i ulët dëme/prime mbetet një çështje tepër delikate dhe që kërkon vëmendje të vazhdueshme. AMF ka ndërmarrë një sërë masash gjatë vitit 2007, të cilat pritet të sjellin efektet e tyre në përmirësimin e cilësisë së trajtimit të dëmeve dhe efektivisht në rritjen e këtij raporti. Përkatësisht janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy udhëzime për trajtimin e dëmeve, bazuar në standartet e OECD si dhe një VKM për licencimin e vlerësuesve të pavarur të dëmeve në sigurime. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të ankesave të ndryshme, krahas detyrimit të vendosur të shoqërive të sigurimit për mbajtjen e një baze të dhënash për ankesat e konsumatorëve, e cila do të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga Autoriteti.

Raporti i shpenzimeve vijoi të mbetet në nivele të larta (55.62%), të ngjashme me ato të vitit të kaluar (56.06%). Me rritjen e pritshme të raportit dëme/prime, shoqëritë duhet të shqyrtojnë me shumë kujdes nivelin e tyre të shpenzimeve për të ruajtur efektivitetin e biznesit.

Raporti i kombinuar dhe ai operativ në një pjesë të shoqërive është brenda kufijve normale. Megjithatë, problem mbetet ndryshimi i tendencave të pjesëve përbërëse të këtij raporti. Nga analiza e këtyre raporteve, rezultojnë që biznesi i sigurimeve në Shqipëri është fi timprurës me një raport operativ në rang tregu në masën 72.93% për vitin 2007, që do të thotë një raport fitimi rreth 27.07%. Kjo situatë është e pazakontë për sa kohë që në pasqyrat fi nanciare të shoqërive të sigurimit dominojnë shpenzimet operative dhe jo shpenzimet për dëmet e paguara.

Tabela 5: Diapazonet e vlerave të indikatorëve financiarë IRIS.

<i>Raporti</i>	<i>Maksimum (%)</i>	<i>Minimum (%)</i>
Norma e Rritjes së Primit	+ 40	- 40
Raporti i Mbajtjes Neto	80	40
Raporti i Shpenzimeve	50	25
Raporti Dëme/Prime	80	50
Raporti i Kombinuar	105	85
Raporti i Investimeve	8	4
Raporti i të Ardhurave të Tjera	1	N/A
Raporti Operativ	101	80
Raporti i Fitimit	20	- 1
Kapitali ndaj Primeve Bruto	50	20
Kapitali ndaj Provigj. Teknike	30	10
Raporti i Aftësisë Paguese	300	150

Treguesit IRIS për 2007



Inspektime në vend (on site) në subjektet e mbikëqyrura

Tregu i sigurimeve

Inspektimi i dëmeve të paguara dhe atyre pezull

Qëllimi i këtij inspektimi me objekt të kufi zuar, ka qenë mbikëqyrja e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit në procesin e administrimit dhe pagesës së dëmeve në funksion të

një trajtimi ligjor dhe të ndershëm të të siguruarve. Mbështetur në faktet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga inspektimi, Bordi i AMF-së, gjatë muajve janar-shkurt 2007, morri vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit dhe administrimit të dëmeve.

Konkluzionet e këtij inspektimi diktuan edhe domosdoshmërinë e unifikimit dhe hartimit të një udhëzimi për procedurat e trajtimit dhe administrimit të dëmeve në sigurime dhe në veçanti të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm motorrik.

Hapat e procesit të inspektimit

- Përcaktimi i qëllimit dhe formës së inspektimit
- Grumbullimi dhe shqyrtimi i të dhënave
- Hartimi i programit të inspektimit
- Emërimi i personelit inspektues
- Prezantimi i programit të inspektimit me drejtuesit e subjektit
- Kryerja e inspektimit
- Hartimi i projekt raportit të inspektimit
- Dërgimi i projekt raportit tek subjekti i inspektuar dhe marrja e opinionit
- Përgatitja e raportit përfundimtar

Bordi i AMF-së, me vendimin e tij nr. 6, datë 30.08.2007, miratoi Udhëzimin Metodologjik “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime.” Nëpërmjet këtij udhëzimi synohet vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme në procedurat e trajtimit të dëmeve të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë

I një rëndësie të veçantë është edhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për

I një rëndësie të veçantë është edhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për

përgjegjësinë ndaj palëve të treta”. Ky udhëzim trajton dëmet pasurore dhe jo pasurore të mbuluar nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm, procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, vlerësimin e dëmit dhe mënyrat dhe afatet e likuidimit dhe kontabilizimit të dëmeve, si dhe mënyrën e trajtimit të ankesave nga policëmbajtësit.

Inspektimi i bilancit të shoqërive të sigurimit për vitin paraardhës

Inspektimi në vend ka verifikuar aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe drejtimet e investimit të tyre, përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit dhe detyrimet e tjera në masë dhe kohë.

- Mbulimi i provigjoneve teknike dhe matematike me aktive sipas kategorive të përcaktuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe V.K.M nr. 268, datë 28.04.2005 “Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike nga shoqëritë e sigurimeve”,
- Vlerësimi i cilësisë së aktiveve dhe nivelin e likuiditetit të tyre,
- Verifikimi i masës së përgjegjëse të marra në sigurim dhe risigurimeve të kryera sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, si dhe akteve përkatëse nënligjore.

Konkluzionet, konstatimet apo çështjet që rezultuan nga ky inspektim i kryer në periudhën Prill - Qershor 2007, shërbyen si bazë për analizën e gjëndjes financiare të shoqërive të sigurimit.

Inspektime të tjera në vend

AMF, në vazhdimësi në vitin 2007, ka kryer inspektime në rrethe të ndryshme të vendit, me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe agjentëve në sigurime, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës së sigurimeve dhe zbatimin e vendimeve të Bordit të AMF.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatuan një sërë parregullsish që kishin të bënin me ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime nëpërmjet personave të palicencuar, apo ushtrimi i veprimtarisë në ambiente të papërshtatshme, ndryshim të kategorive të mjeteve motorrike gjatë shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm.

Pas shqyrtimit të rezultateve të mësipërme, Bordi i AMF-së përcaktoi një sërë masash korrektive dhe penalitetesh në funksion të përmirësimit të situatës. Problemet e sigurimeve motorrike të detyrueshme u trajtuan në mënyrë të vecantë në Vendimin Nr. 8, datë 17 Dhjetor 2007.

Inspektime në vend në fondet private të pensioneve

Gjatë vitit 2007, AMF ka kryer inspektime në fondet private të pensioneve përkatësisht Capital, Garantsig, IPPSSH (APFA). Inspektimi i kryer në këto fonde private të pensioneve nxori një sërë problemesh si, plotësimi i fondit të garancisë dhe plotësimi i numrit minimal të kontribuesve, të cilat u shoqëruan me një sërë masash korrektive nga Bordi i AMF-së.

Tabela 6: Masat administrative të marra nga AMF ndaj shoqërive të sigurimit dhe instituteve private të pensioneve

<i>Masa administrative ndaj</i>	<i>Numri</i>
Shoqërive të sigurimit	56
- Gjoba	4
- Heqje e klasës së sigurimit	2
- Pezullim i përkohshëm i klasës së sigurimit	2
- Plan masash financiare	3
- Masa administrative për personat përgjegjës	14
- Masa korrigjuese	28
- Refuzim rinovimi për licencë agjenti	3
Instituteve private të pensioneve	5
- Masa korrigjuese	5
TOTALI	61

AMF gjatë procesit të mbikëqyrjes me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të tregjeve të mbikëqyrura, ka marrë një sërë masash rregullative ndaj subjekteve përkatëse. Masat e ndërmarra janë kryesisht masa korigjuese, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e pasojave që përbëjnë shkelje të ligjit apo të akteve nënligjore.

Për shoqëritë e sigurimit

Pjesa më dërrmuese e masave administrative i përket shoqërive të sigurimit, për faktin se tregu i sigurimeve dominon në tregun financiar jo bankar.

Gjatë vitit 2007, janë vendosur 28 masa korigjuese, 14 masa administrative ndaj personave përgjegjës, 3 plane masash financiare, 4 sanksione me gjobë si dhe 2 heqje klasash në sigurime dhe 2 pezullime të përkohëshme klasash. AMF ka ndjekur me rigorozitet eliminimin e shkeljeve si dhe zbatimin e gjithë masave korigjuese nga shoqëritë e sigurimit.

Në fokus të veçantë ka qenë i zbatimi i planit të masave financiare për shoqëritë e sigurimit të cilat nuk kanë arritur parametrat tekniko-financiar të nevojshëm për garantimin e detyrimeve konform kërkesave ligjore. Ndërhyrja në kohë nga ana e AMF, me qëllim përmirësimin e situatës financiare nëpërmjet këtij instrumenti mbikëqyrës, ka qenë tepër efiçase në mbrojtjen e interesave të të siguruarve.

Për institutet private të pensioneve

Pavarësisht faktit se tregu i Pensioneve Private është ende në fazat e zhvillimit, AMF ka mbajtur në monitorim të vazhdueshëm përmbushjen e kërkesave ligjore të operatorëve ekzistues, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2007 janë marrë 5 masa korigjuese, me afate të menjëhershme për zbatim, me qëllim funksionimin konform ligjit të instituteve ekzistuese.

2.4 Teknologjia e informacionit


Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është në zhvillim të vazhdueshëm duke patur si strategji ngritjen e shërbimeve për përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut dhe operatorëve, si dhe mirëmbajtjen e përmirësimin e strukturës informatike të brendshme të tij. Gjatë vitit 2007 është bërë nje hap cilësor si në organizimin e strukturën e brendshme dhe në projektimin, ndërtimin dhe administrimin e sistemeve informatike në mbështetje të strategjisë së Autoritetit.

Aktivitetet e sektorit TI, ndahen në aktivitete me qëllim përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut dhe operatorëve të tij dhe aktivitete për mirëmbajtjen dhe

përmirësimin e strukturës informatike të brendshme të Autoritetit.

Ndër projektet më të rëndësishëm të dyvjeçarit 2007-2008 mund të përmendim Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik, të ngritur mbi kërkesën e direktivave evropiane, për të cilën është realizuar me sukses faza e parë e tij, Rregjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik. Sistemi i ndërtuar në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimeve përpunon të tërë informacionin e nevojshëm si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës. Rregjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike, përbën një platformë raportimi dhe identifikimi të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar në përdorim nga data 1 dhjetor 2007.

Procedura funksionale e Rregjistrimit Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike



Ky rregjistër plotëson dhe përmirëson kërkesat e AMF-së për raportim, si dhe nevojat e tregut për një proces më të sigurtë, më të formalizuar dhe më të përshtatshëm të shitjes së policave. Në aspektin afatgjatë rregjistri do të plotësohet me të dhëna për dëmet në sigurimet e detyrueshme motorrike, si dhe do të sigurohet lidhje online me bazat e të dhënave të aksidenteve, identifikimit të personave dhe të mjeteve, përkatësisht me Ministrinë e Brendshme dhe atë të Transportit. Platforma të ngjashme mund të përmendim TRAMER në Turqi nga e cila ky projekt ka trashëguar mjaft karakteristika.

Në rregjistrin e sigurimeve rregjistrohen detaje të policave të sigurimeve të detyrueshme motorrike të lëshuara nga shoqëritë e sigurimeve. Pjesë e procesit është dhe lëshimi i një numri unik në kohë reale nga serveri qendror, ku mbahet rregjistri për çdo policë të shitur.

Numri unik realizon identifikimin e policave, duke mundësuar kështu dhe shmangien e abuzimeve me natyrë falsifi kuese ose mosraportimit të policave. Aktualisht ky rregjistër ndodhet në AMF dhe administrohet prej saj.

Fazat e mëtejshme të projektit


Rregjistri i dëmeve dhe menaxhimi i sistemit

Në përfundim të zbatimit të plotë të Rregjistrimit Online, AMF në bashkëpunim me shoqëritë, do të ngrejë rregjistrin e dëmeve në sigurimet e detyrueshme motorrike, i cili në plan afatshkurtër do të rrisë transparencën dhe shërbimin ndaj klientit dhe në plan afatgjatë liberalizimin e këtij tregu.

Bonus Malus

Në këtë rregjistër, gjithashtu, rol të rëndësishëm në të ardhmen do të luajnë dhe raportet e gjeneruara në sistemin **Bonus Malus**, me fokusim të veçantë mbi liberalizim të mundshëm të tarifave ose kalim të mirëfilltë në përjasjen "Risk Based" për përlogaritjen e kapitalit minimal të kërkuar për këto portofole në varësi të riskut të marrë në sigurim.

Procedura funksionale e Rregjistrimit të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike



Komunikimi me regjistrat e institucioneve të tjera

- Të dhënat e shitjeve në mënyrë automatike krahasohen në AMF me të dhënat nga DPSHTR për saktësinë e targave dhe fuqive motorrike, me qëllim shmangien e abuzimeve.
- Në një të ardhme AMF do të shqyrtojë mundësinë e lidhjes online dhe në kohë reale me ente të tjera shtetërore në mënyrë që të minimizojë sa më shumë abuzimet e mundshme, me qëllim një shërbim më cilësor dhe më korrekt ndaj konsumatorit.

Përfituesi kryesor i një zhvillimi të tillë është konsumatori

Rregjistrat aktualë të shoqërive të sigurimit përfshijnë një informacion të hollësishëm por ende jo tërësisht të standardizuar. Ruajtja e një informacioni më të detajuar, të plotë dhe të standardizuar, ndihmon në zhvillimin e një historiku të sigurimeve për çdo policëmbajtës, si dhe evidenton më së qarti nevojën dhe njohuritë e popullatës për shmangien e rreziqeve financiare me të cilat përballen çdo ditë.

Avantazhet e Rregjistrat të Sigurimeve

Avantazhet për policëmbajtësit

- Ruajtjen e historikut të tyre në vite dhe në kompani, ku do të përfshihen edhe dëmet
- Transparencë dhe siguri më të madhe mbi rreziqet e siguruar
- Lehtësi në marrjen në sigurim
- Përqasje drejt një sistemi Bonus Malus

Avantazhet për Institucionet Financiare që ushtrojnë aktivitet në Tregun e Sigurimeve

- Praktika të standartizuara të marrjes në sigurim
- Shkëmbim informacioni të kontrolluar
- Shmangie të abuzimeve
- Ulje të numrit të të pasiguarve

Platformat dhe sistemet e AMF-së garantojnë

Në drejtim të mbikëqyrjes

- Monitorimin e përditshëm të shoqërive të sigurimit në shitjen e policave të sigurimeve të detyrueshme.
- Kontrollin e korrektesisë së policave nga vetë klientët.
- Automatizimin e proceseve të punës dhe rritjen e efektivitetit dhe vendimmarrjes.
- Minimizimin e gabimeve teknike nëpërmjet njësimimit të përdorimit të platformave të ndryshme nga AMF dhe operatorët e mbikëqyrur.
- Parametra të lartë të sigurisë, si nga ana fizike dhe funksionale.

Në drejtim të efektivitetit të punës së institucionit

- Standardizimin e infrastrukturës të rrjetit dhe të menaxhimit informatik të posteve të punës.
- Forcimin e shkallës së sigurisë së informacionit, duke marrë parasysh sistemet kritike të ndërtuar dhe konfidencialitetin e të dhënave, nëpërmjet rritjes të sigurisë të infrastrukturës informatike dhe aplikimit të rregullave në aksesin dhe përdorimin e brendshëm.
- Përdorimin e “paketave software” të standardizuara në aktivitetin financiar të AMF-së dhe të njohura nga organet e kontrollit apo ato tatimore, duke bërë më transparent funksionimin e vetë Autoritetit.

- Informatizimin e vazhdueshëm të arkivës si dhe dokumentacionit të protokolluar për të lehtësuar dhe mundësuar vazhdueshmërinë e përpunimit të materialeve me afate shqyrtimi relativisht të gjata.
- Minimizimin e procesit të hedhjes së të dhënave, nëpërmjet integritit të produkteve më të avancuara, me rrjedhojë efektivitetin e lartë në përdorimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e tyre profesionale.

2.5 Bashkëpunimi institucional

Bashkëpunimi me institucionet e vendit

AMF ka një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe të rritjes së efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Gjatë 2007, AMF ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave në hartimin dhe më tej miratimin e akteve të ndryshme nënligjore që lidhen me tregun e sigurimeve të detyrueshme motorrike, të cilat në pjesën më të madhe rregullohen nga Ministria e Financave, bazuar në Dekretin nr. 295, datë 15.9.1992 (i ndryshuar në 2001) "Për sigurimin e detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj personave të tretë". Bashkëpunimi ka vijuar edhe në përmirësimin në përgjithësi të kuadrit ligjor të tre sektorëve që mbikëqyr AMF.

Banka e Shqipërisë ka qenë një nga partnerët kryesorë të AMF-së në arritjen e objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare, sipas standardeve dhe praktikave më të mira. Kompleksiteti i produkteve financiare dhe ndërthurja e veprimtarive të fushave të ndryshme të sektorit financiar ka rritur më tej domosdoshmërinë e bashkëpunimit të dy institucioneve rregullatore. Forcimi i bashkëpunimit ndihmon në parandalimin e transferimit të rreziqeve, në rritjen e nivelit të transparencës dhe çon drejt unifikimit të standardeve për sektorin financiar. Në vitin 2007 janë kryer edhe inspektime të përbashkëta në vend, që kanë rezultuar të efektshme në evidentimin e nivelit të riskut të mbartur dhe transferuar nga sektorë të ndryshëm financiarë. Efektiviteti i bashkëpunimit pritet të rritet nga zbatimi i platformave teknologjike të dy institucioneve, çka premtion për një shkëmbim informacioni e komunikim akoma më të plotë e sistematik. Në komunikim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, AMF ka punuar për zgjerimin e tregut dytësor të letrave me vlerë dhe funksionimin e rregjistrave përkatës.

Në vitin 2007 AMF bashkëpunoi me institucione të tjera për një shtrirje më të gjerë të veprimtarisë siguroese, në mbështetje të iniciativës së Qeverisë e të Kryeministrit për mbrojtjen e publikut, apo punonjësve, nga rreziqe potenciale që mbart ushtrimi i disa aktiviteteve në sektorët e ndërtimit, karburanteve, minierave, hotelerisë, etj.

Lidhjet me Ministrinë e Integritimit kanë qenë të pandërprerane funksion të plotësimit të angazhimeve të AMF-së, në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit. Të gjitha ndryshimet ligjore të kryera në 2007 kanë reflektuar në masë të madhe kërkesat e direktivave Evropiane në fushat e sigurimeve, pensioneve dhe letrave me vlerë.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Zhvillimi i tregjeve ndërkombëtare financiare me ritme të shpejta, unifikimi i standardeve rregulluese dhe mbikëqyrëse, është shoqëruar me angazhimin e rregullatorëve të vendeve të ndryshme për zbatimin e këtyre "parimeve të përgjithshme". Në këtë frymë, AMF ka intensifikuar kontaktet dhe shkëmbimin e eksperiencës me homologët dhe ka stimuluar një pjesëmarrje gjithnjë e më shumë aktive në aktivitetet e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë. Bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet akoma më i rëndësishëm për shkak të nevojës së futjes në zbatim të Direktivave të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e 3 organizatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. AMF është pjesëmarrës, me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të Dhënave të Ligjeve të IAIS-it. Synimi i funksionimit të kësaj strukture lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Bashkëpunimi me institucione homologe

AMF ka një komunikim të vazhdueshëm me institucione homologe në rajon e më gjerë.

Sigurimet në fushën e turizmit

- **Ligj nr. 9734, datë 14. 05. 2007 "Për Turizmin"**

Neni 33/4 Çdo njësi akomoduese apo restorant turistik, mban përgjegjësi, për sa kohë që klienti qëndron atje, për sigurimin e jetës sëtij, të standardeve të shërbimit që ai ofron dhe për çdo dëm të shkaktuar në shëndetin, sigurinë dhe pronën e klientit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

- **VKM 12.9.2007** "Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve, rregullave të licencimit, procedurave për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje licence, në fushën e shërbimeve turistike".

Pika 1/ç çdo person fizik a juridik, vendas ose i huaj, subjekt i këtij vendimi, për t'u pajisur me licencë/certifikatë në fushën e shërbimeve turistike, duhet të garantojë sigurinë e përgjegjësisë për dëmet që mund t'u shkaktohen personave nga konsumimi i shërbimit që ofron/ushtron subjekti.

- **Rregullore e MTKRS** "Për kërkesat për regjistrimin dhe klasifikimin e hoteleve, njërive të tjera akomoduese dhe restoranteve turistike." *Paragrafi 8/7* Dokumentacioni që duhet të plotësohet për t'u certifikuar: Policë siguri për strukturën akomoduese dhe për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta.

Këtu vlen të përmendet bashkëpunimi me Autoritetin Bankar Qëndror të Kosovës, me fryte reciproke si në shkëmbimin e eksperiencës, në vendosjen e standardeve, në zhvillimin e trainimeve dypalëshe, ashtu edhe shkëmbimin e informacioneve konfidenciale e kryerjen e inspektimeve të përbashkëta në shoqërite shqiptare në Kosovë. Këto ura komunikimi do të forcohen më tej në funksion të zhvillimit të sektorëve financiarë të dy vendeve.

Pas përfshirjes së interesave Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve, AMF ka vendosur ura komunikimi dhe bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë në funksion të mbarëvajtjes së sektorëve në të dy vendet.

Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Marrëdhëniet me donatorët vazhdojnë të jenë një faktor mbështetës, tepër i rëndësishëm, në realizimin e projekteve strategjike të AMF-së, me qëllim ngritjen institucionale si dhe për nxitjen dhe zhvillimin e hallkave të veçanta të aktivitetit të këtij institucioni.

Bashkëpunimi me Bankën Botërore ka nisur që në hapat e parë të krijimit të institucionit. BB është përfshirë në dhënien e asistencës dhe ekspertizës në drejtime të ndryshme të punës së AMF-së. Vlen të përmendim projektet e nisura për përmirësimin e bazës ligjore dhe metodologjisë së mbikëqyrjes. Konsultime të vazhdueshme ka patur edhe në drejtim të gjetjes së një skeme të përshtatshme kombëtare, apo rajonale, të mbulimit të vendit nga katastrofat natyrore sipas shembujve të vendeve të tjera të rajonit.

Në kuadër të monitorimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, FMN ka ndjekur me vëmendje dhe ka asistuar punën e AMF-së në rregullimin dhe forcimin e tregjeve financiare jo-bankare. FMN po asiston në mënyrë të veçantë rregullimin e sistemit të pensioneve në Shqipëri dhe për këtë qëllim ka dhënë edhe rekomandimet e saj për hapat që duhen hedhur deri në krijimin e kuadrit të plotë ligjor dhe hartimin e strategjisë së pensioneve.

Përfshirja e elementëve të direktivave Evropiane në sistemin financiar në Shqipëri ka nxitur bashkëpunimin e AMF-së me strukturat e Evropës së Bashkuar. Ky bashkëpunim po konkretizohet në trainime dhe asistencë të ofruara nga projekti TAIEX në fushat e sigurimeve dhe pensioneve.



Bashkëpunimi me FSVV (Financial Services Volunteer Corps) - Viti 2007 ka qenë edhe kurorëzimi i një bashkëpunimi të suksesshëm me USAID dhe FSVV, në certifikimin e grupit të parë të aktuarëve profesionistë në Shqipëri, të përbërë prej tetë specialistësh. Në zbatimin e këtij projekti është bashkëpunuar ngushtë edhe me Universitetin e Tiranës. Ky është një hap i

rëndësishëm në konsolidimin e profesionit të Aktuarit në Shqipëri, si një element tepër i rëndësishëm, jo vetëm në vendosjen e standardeve, por edhe në implementimin me sukses të projekteve të të ardhmes, si Mbikëqyrja me Bazë Risku. Ndërkohë ky program do të vazhdojë të japë mbështetjen e tij të vazhdueshme në kuadrin e zhvillimit të mëtejshëm të kësaj fushe në Shqipëri.

Bashkëpunimi me Bankën Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH)

- Po vijon puna për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e letrave me vlerë, ku vlen të përmendet projekti i ri i ligjit të letrave me vlerë të hartuar nga Ministria e Financave, projekti në proces mbi Obligacionet e Korporatave dhe Bashkive të mbështetur nga BERZH-i. Këto projekte synojnë përafrimin me direktivat Evropiane dhe nxitjen e aktivizimit të tregut. Bashkëpunimi me BERZH-in ka dhënë frutet e veta edhe në finalizimin e projektit të sistemit të menaxhimit të informacionit për AMF-në.

Në sajë të një bashkëpunimi të frytshëm me USAID dhe Programin e Partnerëve për Stabilitet Financiar (PFS), AMF ka organizuar një Workshop Rajonal për Qeverisjen e Kompanive të Sigurimit, me pjesëmarrje të gjerë nga Institucionet Homologe të Rajonit, ekspertë të fushës, si dhe Drejtues të Kompanive të Sigurimit në vend. Mesazhi që u përcoll në këtë aktivitet ishte tepër i rëndësishëm, në kuadrin e promovimit e shkëmbimit të eksperiencës dhe ekspertizës në rajon, si dhe përf forcimin e aftësive, me qëllim mbikëqyrjen efektive.



Seminar mbi qeverisjen e shoqërive


2.6 Marrëdhëniet me publikun, transparenca

Në përbushje të misionit themelor të mbrojtjes së interesave të publikut, AMF i ka kushtuar rëndësi të veçantë rritjes së nivelit të transparencës dhe gjetjes së formave dhe mënyrave efektive të komunikimit.

Gjatë vitit 2007 u bë i mundur hartimi dhe realizimi i faqes së internetit të AMF-së, që sot rezulton interaktive dhe me një numër të konsiderueshëm vizitorësh në rritje. Vizitorët gjejnë në faqen e AMF-së informacion të larmishëm mbi zhvillimet e fundit të tregjeve fi nanciare jo-bankare. AMF punon në mënyrë të pandërprerë për rritjen e cilësisë së informacionit dhe transmetimit të tij në forma dhe mënyra që u përshtaten grupeve, apo individëve të ndryshëm.



AMF – Departamenti i Kërkimit, TI & Statistikës



Ndryshimet në kuadrin rregullativ, ndikimet që ato kanë tek sektorët financiarë apo tek klientët, zënë një vend shumë të rëndësishëm në komunikimin e AMF-së. AMF publikon projektaktet rregullative para miratimit të tyre, duke i lënë vend komenteve, apo sugjerimeve për përmirësime nga të gjitha palët e interesuara.

Raportet periodike statistikore të tregjeve financiare jo-bankare pasqyrojnë dinamikën e zhvillimit të tyre dhe bëjnë analiza të detajuar të treguesve të tregjeve në përgjithësi dhe sjelljes së operatorëve të veçantë.

Gjatë vitit 2007, AMF përmirësoi ndjeshëm përmbajtjen dhe formën e raportit mujor statistikor të tregut të sigurimeve, sipas praktikave të suksesshme ndërkombëtare. Lexuesi tashmë ka në dorë një raport dinamik që jep pasqyrën e plotë të zhvillimit të sektorit të sigurimeve.

Realizimi me sukses i projektit GSRM në Dhjetor 2007, i çeli publikut një dritare për t'u lidhur drejtpërdrejt me zhvillimet e fundit në tregun e letrave me vlerë.

Realizimi me sukses në vitin 2007 i fazës së parë të projektit të Qendrës së Rregjistrimit të Sigurimeve Motorrike, shënoi një hap tjetër cilësor të shërbimit ndaj publikut. Pas fillimit të funksionimit të Qendrës, AMF u mundësoi mbajtësve të mjeteve motorrike verifikimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet rubrikës “Verifiko policën tënde”, duke u dhënë njëkohësisht edhe orientimet përkatëse për të bërë korrektimet e nevojshme.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit Autoriteti i Mbrojtjes Financiare njofton publikun se nga data 1 Dhjetor 2007 ka hyrë në funksionim të plotë Rregjistrimi Elektronik Online i Shqiptarëve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik.

Cdo policë e sigurimit të detyrueshëm motorrik shërbet nga përfaqesues të autorizuar të shoqërive të sigurimit. Polica lëshohet nëpërmjet sistemit kompjuterik të lidhur online me Autoritetin e Mbrojtjes Financiare. Polica ka të prituruar në pjesën e sipërme apo të poshtme të saj një kod numrash dhe shifrash me 15 karaktere që përben kodin identifikues të raportimit të gjenituar automatikisht në kohë reale nga serverit e Autoritetit.

Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të afishojnë çmimet e policave të sigurimit të detyrueshëm në çdo pllakë të tyre të shqiptarëve.

Kontrolli i mëposhtëm është i vlefshëm për policat e sigurimit të lëshuara pas datës 1 Dhjetor 2007.

Plotësoni Kriteret e Kërkit për Policën

(*) Plotësoni Targën e Mjedit dhe Numrin Serial ose Numrin e Shasit

Liqi i policës:

* Targa e Mjedit:

* Numri Serial:

* Numri i Shasit:

Nëse policë nuk gjendet, ju lutem njoftoni AMF-në në adresën konsumatori@amf.gov.al ose në telefon +355 4 269 329.

Njoftojmë konsumatorit që në momentin e blerjes së policës të sigurueshin që:

Hyrje e Autorizuar

- Përdoruesit e Tregut
- Përdoruesit e Brevetave

Mbrojtja e Konsumatorit

- Verifikoni policën tuaj të sigurimit të detyrueshëm motorrik
- Treguesit e entesave të konsumatorit
- Në kontaktimi në:
 - konsumatori@amf.gov.al
 - telefon: +355 4 269 329

Info të Vlefshme

- Statistikë
- FAQ

Informacione të tjera të rëndësishme në dorë të publikut lidhen me aktivitetin e AMF-së dhe Bordit, lajme dhe njoftime me karakter orientues dhe mbrojtës për publikun, informacione të mirëfillta edukuese për produktet financiare jo-bankare dhe rëndësinë e tyre.

Periodiku mujor i AMF-së, i nisur në Nëntor 2007, përmban informacione të larmishme të zhvillimit të sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri, njohuri mbi praktikat më të mira të përshtatura nga tregjet e ndryshme dhe shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve në vende të ndryshme të botës.



Një vend të veçantë zënë informacionet e detajuara mbi të gjithë operatorët e mbikëqyrur, ku përfshihen edhe klasat apo produktet për të cilat janë licencuar. AMF ka instruktuar përkatësisht publikun për të reaguar ndaj produkteve, apo operatorëve të paautorizuar, përveç masave që ka marrë për eliminimin e dukurive të kësaj natyre.

Botime të tjera së shpejti

“Buletini statistikor për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë”

- statistika tremujore të tregut

“Gjeografia e Sigurimeve” - informacion mbi shpërndarjen gjeografike të tregut të sigurimeve sipas prefekturave të vendit

“Raporti i Mbrojtjes” - informacion financiar i standardeve bashkëkohore për tregun e sigurimeve

3. Mbrojtja e Konsumatorit

Komunikimi dhe transparencja ndaj publikut, e trajtuar më sipër, përbën një nga mjetet e AMF-së në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2007, janë ndërmarrë një sërë reformash rregullative dhe institucionale që kanë synuar rritjen e rolit të AMF-së si mbrojtës dhe garantues i interesave të klientëve dhe konsumatorëve në tërësi.

Iniciativa rregullative

Krijimi i grupit të punës për hartimin e një projektudhëzimi standard “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” me pjesëmarrjen e gjerë të përfaqësuesve të AMF-së, shoqërive të sigurimit, BSHS-së dhe përfaqësuesve të interesave të publikut.

Propozimi i grupit të punës gjeti miratimin e Ministrisë së Financave, në Udhëzimin nr. 24, datë 15.11.2007. Hyrja në fuqi e këtij udhëzimi i detyron shoqëritë e sigurimit të raportojnë në AMF të gjitha ankesat që ato marrin në lidhje me procesin e trajtimit dhe pagesës së dëmeve.

AMF u ka kërkuar konsumatorëve të sjellin në adresë të saj pakënaqësitë, apo ankesat mbi shërbimin e ofruar nga operatorët e mbikëqyrrur, kryesisht në drejtim të procesit të dëmshpërblimit nga shoqëritë e sigurimit.

Njësia për trajtimin e ankesave pranë AMF punon bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për të zgjidhur në mënyrë profesionale, të paanshme dhe të shpejtë ankesat që i paraqiten.

Gjatë vitit 2007 janë trajtuar një sërë ankesash të depozituara në Autoritet nga ankimues të ndryshëm si persona fizikë, ente shtetërore dhe subjekte juridike dhe në të shumtën e rasteve me ndërhyrjen e Autoritetit është gjetur zgjidhja e tyre.

Për të gjitha rastet e ankimuar është ndjekur një metodologji standarde, që fillon me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimet e dhëna nga AMF për trajtim të praktikës në zbatim kuadrit ligjor në fuqi dhe vijon me kontakte të vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhjen optimale të problemit.

Prej shtatorit 2007, periudhë e cila përkon me krijimin e strukturës së veçantë për mbrojtjen e konsumatorit, janë depozituar në Autoritet 22 ankesa që lidhen me dëmshpërblimin për kontrata të sigurimeve të detyrueshme motorrike dhe sigurime të garancisë. Nga këto praktika, 12 janë zgjidhur konform kuadrit ligjor, 5 praktika pritet të plotësohen me dokumentacionin e nevojshëm nga ana e palës kërkuese dhe 5 të tjera janë në proces gjyqësor midis shoqërisë së sigurimit dhe palës kërkuese të dëmit.

Kompetenca e AMF-së

**Ligji nr. 9267, date 29.7.2004
“Për veprimtarinë e sigurimit,
të risigurimit dhe
ndërmjetësimin në sigurime dhe
risigurime” neni 163, pika 3,4.**

(3) I siguruari ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit, nëse mbetet i pakënaqur nga trajtimi i ankesës nga shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj.

(4) Autoriteti gëzon të drejtën, kur e çmon të nevojshme, t'i kthejë për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj çështjen e ankimuar.

PJESA II

TREGJET E MBIKËQYRURA

II.1 Tregu i sigurimeve


Vështrim i përgjithshëm

Për nga rritja, zhvillimet dhe ngjarjet e veçanta, viti 2007 mund të quhet edhe si viti i sigurimeve në Shqipëri. Gjatë vitit 2007 vijuan veprimtarinë e tyre dhjetë shoqëritë e sigurimeve, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të jo-jetës, dy shoqëri të sigurimit të jetës dhe një shoqëri kompozite e jetës dhe jo -jetës.

2007 – Viti i sigurimeve

- Tregu i sigurimeve u **rrit me 31%** në krahasim me 2006.
- Kërkesa për nivelin minimal të fondit të garancisë (**kapitali minimal**) të shoqërive të sigurimit u përshtat **sipas direktivave Evropiane**.
- Futja e sistemit **IRIS** në analizën financiare të shoqërive të sigurimit.
- **3 kompani të huaja shumë profesionale** konkretizuan investimet e tyre në tregun shqiptar të sigurimeve.
- U hartuan **udhëzime dhe rregullore** të reja nën dritën e direktivave Evropiane **për dëmet, investimet, ndërmjetësit, etj.**
- U rrit niveli i komunikimit dhe transparencës së AMF-së nëpërmjet faqes interaktive të internetit:
 - *Për shoqëritë:* (i) **Informacione të përditësuara** në faqen e tyre të veçantë;
(ii) **Informacion ditor mbi sigurimet e detyrueshme** on-line me serverin e AMF-së.
 - *Për publikun:* **Materiale informative dhe edukuese** për sigurimet; gjithë **kuadri ligjor; përditësim** mbi ecurinë e tregut; **"Mbrojte të konsumatorit"** - **adresa kontakti** për ankesat e konsumatorëve dhe njësi e veçantë për trajtimin e tyre; verifikim të policave të sigurimit të detyrueshëm në rubrikën **"Verifiko policën tënde"**.
- U propozuan amendimet në kuadrin ligjor për **nxitjen e produkteve të sigurimit** të përgjegjësishë në sektorët e karburanteve, ndërtimit, minierave, hotelarisë.

Zhvillimi i tregut të sigurimeve në 10 vitet e fundit (në milionë lekë)




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve arritën shifrën **5.9 miliardë lekë**, ose rreth **31% më shumë** se shifra përkatëse e vitit 2006. Rritja e primeve në vitin 2007 është e konsiderueshme krahasuar me rritjen në vitet paraardhës (13% në vitin 2006 dhe 4.7% në katër vitet paraardhës). Megjithatë vlen të përmendim që zhvillimi i sektorit mbetet ende larg potencialeve që ofron vendi dhe niveleve të zhvillimit në vende të tjera të rajonit. Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e jetës, sërish 93% e primeve u gjenerua nga sigurimet e jo-jetës. Në vitin 2007 u nënshkruan rreth 544 mijë kontrata sigurimi, ose rreth 7% më shumë se në vitin 2006. Rritja e pasqyruar në vëllimin e primeve nuk u shoqërua me ritëm të ngjashëm në pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit. Treguesi i dëmeve mbeti sërish në nivele shumë të ulta dhe larg sjelljes së tregjeve të rajonit e Evropës.

Viti 2007 shënoi realizimin e suksesshëm të investimeve të huaja serioze në tregun shqiptar të sigurimeve. Në vitin 2007 në Shqipëri investuan Aspiss Group (Prill), Uniqa (Korrik) dhe Vienna Insurance Group (Gusht).

Tabela 7: Primet e shkruara bruto 2007

Lloji i sigurimit	Numri i kontratave	Primet e Shkruara Bruto	
		(në mln lekë)	(konvertuar në mijë euro)
A Sigurime të detyrueshme	334,828	3,868	31,285
B Sigurime vullnetare	208,915	2,080	16,826
B1 Sigurimi i jetës	40,933	410	3,316
B2 Sigurimi i jo-jetës	167,982	1,670	13,510
TOTAL	543,743	5,948	48,111


Struktura e tregut të sigurimeve në 2007




Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2007 sigurimet e detyrueshme motorrike (të përgjegjësishë së mbajtësve të mjeteve motorrike ndaj palëve të treta) vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë rreth 65% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve. Sigurimet e detyrueshme motorrike rregullohen me një ligj të vitit 1992 të plotësuar me akte nënligjore të Ministrisë të Financave. Sistemi tarifor për këto produkte është i paliberalizuar dhe rregullohet me akte nënligjore të Ministrisë të Financave. Edhe gjatë vitit 2007 tregu i sigurimeve të detyrueshme paraqiti probleme që kryesisht u lidhën me uljen e çmimeve prej shoqërive të sigurimit nën nivelet minimale të lejuara.

Zhvillimi i sigurimeve të detyrueshme në vite





Për stabilizimin dhe përmirësimin e situatës së tregut të sigurimeve të detyrueshme, AMF ka ndërmarrë masa të shumta, ku përmendim:

- rregulloren e funksionimit të pikave të shitjes të produkteve
- ngritjen e Qendrës së informacionit
- kryqëzimin e informacionit të policave me atë të të dhënave të DPSHTRR-së
- kontrollet e vazhdueshme në vend për shitjet
- garantimin e detyrimeve ndaj publikut nëpërmjet kontrollit të provigjoneve teknike dhe pasqyrave financiare
- rregullat e reja të investimit të provigjoneve teknike të miratuara me VKM

Ulja e çmimit prej shoqërive të sigurimit çënon efektivitetin e biznesit të tyre. Ndërkohë, shoqëritë po bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme që fokusimi drejt TPL-së dhe lënia mënjanë e produkteve vullnetare mund të ndërlikojë shumë shpejt situatën e tyre financiare dhe jetëgjatësinë e aktivitetit të tyre. Sigurimet e detyrueshme përbëhen nga: (i) sigurimi TPL e brendshme, (ii) Kartoni Jeshil dhe (iii) kontrata e sigurimit kufi tar.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme në vitin 2007 arritën në rreth 2.57 miliardë lekë, ose rreth 43% më shumë se në 2006. Në rritjen e tregut të TPL-së ndikuan njëkohësisht rritja e numrit të klientëve dhe ndryshimi i çmimeve minimale të katër muajve të parë të vitit 2007 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2006.


Në vitin 2007, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin rreth 793 milionë lekë, ose rreth 23% më shumë se në vitin 2006. Listës së shoqërive që vepronin në tregun e kartonit jeshil: Atlantik sh.a, Insig sh.a, Sigal sh.a dhe Sigma sh.a iu shtua gjatë vitit 2007 edhe shoqëria Albsig sh.a. Çmimet fikse të këtij produkti janë të detyrueshme për operatorët në treg.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2007 arritën në rreth 502 milionë lekë, apo rreth 5.2% më pak se në vitin 2006. Duhet theksuar se çmimet e aplikuara nga shoqëritë e sigurimeve në vitin 2007 ishin më të ulta se ato të një viti më parë. Konkurrenca në këtë produkt u rrit si rezultat i rritjes së numrit të rrjeteve të shitjes nga shoqëritë e sigurimeve.

Sigurimet vullnetare

Në vitin 2007, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 2 miliardë lekë, ose 33% më shumë se të ardhurat e një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare u lidh ngushtë me rritjen e nivelit të kreditimit nga bankat dhe hyrjen e disa investitorëve të mëdhenj kryesisht në ndërtimin e rrugëve.

Zhvillimi i sigurimeve vullnetare të jo-jetës në vite



AMF në bashkëpunim me shoqatën e siguroesve hartoi një projekt për nxitjen e produkteve të sigurimeve në sektorët e turizmit, karburanteve, ndërtimit dhe të gjitha koncesioneve. Projekti synoi sigurimin e përgjegjësive të pronarëve të bizneseve të mësipërme ndaj dëmeve që mund t'i shkaktojnë publikut për shkak të veprimtarisë së tyre. Në bashkëpunim me ministrinë e linjave u hartuan ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor, që përfshijnë kërkesën për sigurim si kriter të licencimit dhe më tej të ushtrimit të veprimtarisë. AMF po bashkëpunon me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale e Shanceve të Barabarta për të përcaktuar detyrimin për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve të disa profesioneve të konsideruara si të vështirësisë së lartë.

Sigurimi i përgjegjësive të mësipërme pritet të fillojë brenda vitit 2008. Efektet pozitive do t'i ketë së pari publiku që do të dëmshpërblehet menjëherë pas dëmtimit, së dyti vetë biznesi i siguruar që nuk do të cënohet financiarisht dhe së treti sektori i sigurimeve. Rritja e të ardhurave të sektorit të sigurimeve do të shoqërohet me diversifikimin e portofolit të sigurimeve dhe uljen e rolit të tanishëm të sigurimeve motorrike.

- Në sigurimet vullnetare të jo-jetës me të ardhura rreth 1.67 miliardë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 35% të të ardhurave të këtij grupi, të pasuara nga sigurimi kasko me rreth 22% dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me rreth 19%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit si dhe sigurimet e garancisë.
- Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në 2007 arritën në rreth 186 milionë lekë, ose rreth 8% më shumë se 2006. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 88% të të ardhurave të këtij grupi. Investimet e huaja


në sigurime në 2007 u shoqëruan me interesin për futjen e produkteve të reja kryesisht në fushën e shëndetit.

- Primet në sigurimet e jetës në vitin 2007 arritën në rreth 410 milionë lekë, ose rreth 36% më të larta se në vitin 2006. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredihënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie. Produktet e tjera të mirëfillta të jetës mbeten ende të pazhvilluara në Shqipëri. AMF në bashkëpunim me Bankën Botërore, do të organizojë në Prill 2008 një seminar të veçantë mbi sigurimet e jetës me pjesëmarrës nga të gjithë shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri.


Dëmet

Qëllimi kryesor i siguruesve në treg duhet të jetë përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve dhe që lidhen me pagesën e dëmeve. Gjatë vitit 2007 shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 1.29 miliardë lekë dëme, ose rreth 0.53% më shumë se në 2006. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur në të djathtë, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve të detyrueshme me 874 milionë lekë, apo 68% të totalit. Raporti i ulët dëme/prime tregon se tregu ka shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

Struktura e dëmeve të paguara në 2007



Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në vite në milionë lekë



Risigurimet


Gjatë vitit 2007 niveli i primeve të kaluara në risigurim është rritur, çka përkon dhe me rritjen e volumit të primeve të shkruara. Në 2007 primet e ceduara në risigurim arritën vlerën prej 773 milionë lekë, ose rreth 13% e totalit të primeve të shkruara bruto. Një pjesë të rëndësishme zënë primet e ceduara nga risigurimi për mbulimin e përgjegjësive inxhinierike të Projektit "Durrës-Kukës-Morinë" me një volum prej 182 milionë lekë. Shoqëritë kanë kryer risigurimin e portofoleve, apo kontratave të veçanta të sigurimit në funksion të rritjes së kapacitetit të tyre dhe zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha.

Marrëveshjet e risigurimit të shoqërive mbulojnë portofolet e kartonit jeshil, të pronës, të TPL-së së brendshme dhe të jetës së debitorit. Gjatë vitit 2007 shoqëritë kanë kryer edhe risigurime fakultative në mbulim të rreziqeve të veçanta që janë jashtë kapacitetit të tyre automatik. Kontratat fakultative të risigurimit kanë mbështetur kontratat origjinale të sigurimit të shoqërive kryesisht në sigurimet inxhinierike, sigurimet e marinës e aviacionit dhe sigurimet e përgjegjësive.

Gjatë vitit 2007 AMF rishikoi rregulloret e risigurimeve në funksion të forcimit të cilësisë së risiguruesve, bazuar në klasifi kimin e tyre prej agjencive ndërkombëtare. AMF ka shqyrtuar të gjitha marrëveshjet dhe kontratat fakultative të risigurimit, në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kriteret e cilësisë së risiguruesve. Më shumë se 80% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit, rezultojnë me klasifi kim më të lartë se BBB- nga Standard & Poors, dhe mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në programet e risigurimit mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Syndicate of Lloyd's, Revios, Converium, etj.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2007 tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës u nda ndërmjet kompanive të



sigurimeve: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Në vitin 2007, shoqëria Sigal mbajti vendin e parë në volumin e primeve të shkruara bruto.

Gjatë vitit 2007 aktivitetin e sigurimit të jetës e ushtruan kompanitë Sigal Life, Insig dhe Sigcred. Sigal Life udhëhoqi tregun me rreth 39% të primeve.

II.2 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë, vazhdon të dominohet nga tregtimi në tregun primar dhe atë sekondar të instrumenteve të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), ndërsa tregu i letrave me vlerë të aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar dhe i kufizuar kryesisht në tregun informal të aksioneve të kompanive të regjistruara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Vitet e fundit vihet re një rritje e konsiderueshme e interesit të subjekteve të ndryshme vendase dhe të huaja për t'u licencuar dhe ushtruar aktivitetet në tregun vendas të letrave me vlerë.

Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Gjatë vitit 2007, ky tregu dominua krejtësisht nga transaksionet në instrumentet afatshkurtër (bonot e thesarit). Zgjerimi i tregut me operatorë të tjerë, si dhe thellimi i tregut të letrave

Tabela 8: Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2007

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2006 ⁴	2007	'07 / '06-1
A Blerje në tregun primar	9,561.91	9,183.37	(3.96)
Individë	5,160.45	6,108.82	18.38
Persona juridikë	4,401.46	3,074.54	(30.15)
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit	6,519.16	8,634.71	32.45
Individë	-	8,419.70	-
Persona juridikë	-	215.01	-
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	1,737.47	522.78	(69.91)
Individë	-	468.18	-
Persona juridikë	-	54.60	-
D Vendosje e bonove si kolateral	34.48	83.46	142.04
Individë	-	49.02	-
Persona juridikë	-	34.44	-
E Shlyerje e vlerës nominale në maturim	3,059.02	5,554.98	81.59
Individë	-	4,197.03	-
Persona juridikë	-	1,357.95	-

⁴Për vitin 2006 të dhënat nuk disponohen të ndara për transaksionet sipas personave fizikë apo juridikë

me vlerë të Qeverisë me instrumenta borxhi me afat më të gjatë maturimi, pritet të rrisë edhe fluksin e transaksioneve në tregun me pakicë të këtyre instrumenteve.


Viti 2007 shënoi rritje të nivelit të transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, krahasuar me vitin paraardhës.

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2007, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë transaksioni i llojit A “Blerje në tregun primar” me 38.30% dhe vendin e dytë transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit” me 36.01% të totalit të tregut.

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit” ka pësuar një rritje prej 2,155 milion lekë ose 32.45% krahasuar me një vit më parë dhe numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një rritje prej 40.82%. Në këtë lloj transaksioni vlen të përmendet që rritja më e madhe ka ndodhur në grupin e individëve që zënë dhe 99.35% të totalit të këtij lloj transaksioni.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” ka pësuar një ulje prej 1,215 milion lekë ose 69.91% krahasuar me një vit më parë dhe numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një ulje prej 40.56%. Kjo ulje nuk pengon në rritjen në vlerë absolute të totalit të transaksioneve të llojit B dhe C në krahasim me vitin 2006. Rritja kap vlerën 900.86 milion lekë ose 10.91%.

Letra me Vlerë të Qeverisë sipas llojit të transaksionit



GSRM (Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë)

Duke filluar nga data 1 Dhjetor 2007, AMF prezantoi një platformë elektronike online, GSRM, ku çdo bankë e licencuar për të vepruar në tregun me pakicë, përditëson në kohë reale transaksionet dhe kuotimet për bonot e thesarit dhe obligacionet. Kjo i shërben rritjes së transparencës dhe stimulimit të përfshirjes së publikut në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

GSRM është ideuar dhe konceptuar nga AMF, në formën e një platforme të përbashkët të shpërndarjes së informacionit, nëpërmjet publikimit të detyrueshëm të të dhënave mbi veprimet e ekzekutuara nga operatorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Kjo platformë është vënë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të AMF-së.



Qëllimi i platformës GSRM

Qëllimi i ndërtimit të platformës GSRM është dhënia e një informacioni më të plotë dhe të përditësuar publikut dhe investitorëve institucionale në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumentave të borxhit të Qeverisë. Bazuar në këtë informacion investitorët mund të drejtohen në atë bankë që ofron çmimin më të mirë.

GSRM do të përfshijë edhe një bazë të dhënash historike, e cila do t'i vijë në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Avantazhet e GSRM

- Rrit transparencën në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë
- Krijon mundësinë e informimit të vazhdueshëm e në kohë reale të investitorëve
- Rrit konkurrencën mes operatorëve në treg
- Zvogëlon kostot operacionale të tregtimit në letra me vlerë të Qeverisë
- Zvogëlon mundësinë e abuzimeve në treg
- Krijon mundësi për një mbrojtje më të mirë dhe më efektive të investitorëve
- Krijon premisat për zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar të letrave me vlerë

Tregu i kapitaleve

Tregu i aksioneve mbetet ende i pazhvilluar. Ky treg përbëhet nga tregu zyrtar (Bursa e Tiranës), tregtarët e licencuar për të tregtuar në letra me vlerë dhe tregu informal i

transaksioneve mbi aksionet e shoqërive aksionere.

Bursa e Tiranës (BT), e krijuar që në vitin 1996, është shoqëri anonime shtetërore me pronar të vetëm Ministrinë e Financave, e licencuar nga AMF si treg i organizuar i letrave me vlerë të borxhit dhe aksioneve. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, ky institucion nuk ka arritur të bëhet tërheqës për biznesin vendas. Edhe gjatë vitit 2007, në Bursën e Tiranës nuk ka asnjë shoqëri tregtare të listuar.

Mund të përmendim një interes gjithnjë e në rritje të subjekteve të huaja dhe vendase për listime eventuale apo për zhvillimin e aktivitetit të tregut apo ndërmjetësimit. Zhvillimi i shpejtë i ekonomisë dhe i sektorit financiar shtrojnë nevojën e intensifikimit të procesit të zhvillimit të tregut të kapitaleve. Qeveria mund të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së zhvillimit të këtij sektori, kryesisht nëpërmjet privatizimit të një pakete aksionesh të kompanive strategjike shtetërore në tregun e kapitaleve dhe nëpërmjet ofrimit të incentivave të ndryshme fiskale e ligjore për të nxitur biznesin vendas të shfrytëzojë këtë treg dhe listimin në bursë si një mjet financimi. Është e nevojshme pasja e një politike të qartë për zhvillimin e tregut, e mbështetur nga Qeveria dhe institucionet financiare rregullatore.

Në mungesë të një tregu formal, aksionet vazhdojnë të tregtohen në mënyrë të paorganizuar, që konsiston kryesisht në transaksionet e ekzekutuara mes aksionerëve të shoqërive të privatizuara. Ky treg vazhdon të jetë aktiv ndonëse nga viti në vit ka ardhur në rënie për shkak të konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara. Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, të gjitha shoqëritë që kanë mbi 50 aksionerë duhet të rregjistrohen pranë një regjistri të pavarur e të specializuar. Për rrjedhojë, regjistrimi si dhe pastrimi e rregullimi i llogarive për transaksionet e ekzekutuara në aksione realizohet nga Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve (QRA).

QRA, është shoqëri anonime shtetërore, e licencuar nga AMF si regjistër i letrave me vlerë të pronësisë. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), QRA ofron edhe shërbime të tjera korporative për shoqëritë e rregjistruara. Në fund të vitit 2007, QRA numëron 49 shoqëri aksionere të rregjistruara, 14 prej të cilave janë institucione

Tabela 9: Statistika mbi transaksionet e rregjistruara në QRA gjatë 2007

<i>Nr. Klasifikimi</i>	<i>Statistika</i>
1. Nr. Total i shoqërive aksionere të regjistruara pranë QRA-së	49
2. Nr. Total i aksioneve të shoqërive të regjistruara prënë QRA-së	13,583,165
3. Nr. Total i shoqërive aksionet e të cilave janë tregtuar	25
4. Nr. Total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2007	262
5. Nr. Total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2007	646,788
6. Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2007	4.76%

Burimi: Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve

financiare (3 banka, 10 kompani sigurimesh dhe 1 regjistrar letrash me vlerë).

Numri total i shoqërive të regjistruara pranë QRA-së gjatë vitit 2007, në krahasim me vitin 2006, pësoi një rritje në masën 2%. Gjatë vitit 2007, QRA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionere 262 transaksione, krahasuar me 140 transaksione të kryera në vitin 2006. Numri i aksioneve të tregtuara në tregun e paorganizuar gjatë vitit 2007 përbën rreth 4.76% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së, çka tregon për shkallën e ulët të likuiditetit që karakterizon këtë treg.

Qendra e regjistrimit të aksioneve (QRA)

QRA vepron me licencë që nga viti 2002 me objekt regjistrimin e aksioneve të shoqërive anonime. Shoqëritë anonime me mbi 50 aksionerë kanë detyrimin ligjor për mbajtjen e regjistratit të aksioneve të tyre pranë një qendre të pavarur regjistrimi. QRA, krahas mbajtjes së regjistratit, me kryerjen e transaksioneve bën edhe azhurnimin e tij. QRA ofron edhe shërbime të tjera si:

- njoftimi i mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së aksionerëve
- llogaritjen e dividendëve

II.3 Tregu i pensioneve private suplementare


Zhvillimi i instituteve të pensioneve private suplementare

Gjatë vitit 2007, në tregun e pensioneve, kemi të njëjtën shkallë të ulët zhvillimi si gjatë vitit 2006. Në treg vazhduan të ushtrjnë veprimtarinë e tyre tre institute private të pensioneve, përkatësisht IAPPSSH, Capital dhe Garantsig me një numër total prej 2872 kontribuesish dhe 32.1 mln lekë, fond të akumuluar në total.

- Shoqëria **“Garantsig Instituti Privat i Pensioneve sh.a”** ka filluar aktivitetin e saj në Janar 2006. Për periudhën janar – dhjetor 2007, shoqëria ka rreth 875 kontribues me rreth 3.7 milion lekë kontribute.
- Shoqëria **“IAPPSSH sh.a”** (Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare Shqiptare) ka filluar aktivitetin e saj në Janar 2006. Për periudhën janar – dhjetor 2007, shoqëria ka 1,366 kontribues me rreth 25.6 milion lekë kontribute, të investuara këto kryesisht në bono thesari.
- Shoqëria Instituti Privat i Pensioneve **“Capital sh.a”** filloi aktivitetin në Mars 2006. Për periudhën janar-dhjetor 2007, ky institut mblodhi 2.8 milion lekë kontribute, me rreth 631 kontribues.

Tabela 10: Struktura e Tregut të Pensioneve Private në vitin 2007

<i>Shoqëria</i>	<i>Numri kontribuesve</i>	<i>Vlera Kontributeve në lekë</i>
IAPPSSH	1,366	25,608,870
Capital	631	2,801,000
Garantsig	875	3,727,027
TOTAL	2,872	32,136,897




Kuadri ligjor ekzistues që rregullon aktivitetin e pensioneve private suplementare ka mangësi të shumta. Ndërkohë, AMF po punon për hartimin e një projektligji të ri që do të çelë hapësira zhvillimit të sektorit sipas parimeve dhe praktikave më të mira.

Në bashkëpunim me TAIEX, AMF është duke organizuar një seminar, i cili do të fokusohet në mundësitë e zhvillimit të tregut të pensioneve private, mikëqyrjen e tyre dhe eksperiencën ndërkombëtare në këtë fushë. Ky seminar do të paraprihet nga një mision ekspertësh, i cili do të evidentojë situatën aktuale të Sistemit Privat të Pensioneve në Shqipëri, perspektivat e zhvillimit të tregut në Shqipëri, anën rregullative në përputhje dhe me parimet e IOPS si dhe mbikëqyrjen me bazë risku për fondet private të pensioneve.

SHTOJCA A

Struktura e AMF



SHTOJCA B

Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin jo - bankar

Në Fushën e Sigurimeve

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr.9267, datë 29.07.2004.	Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.	Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në këtë ligj.
Dekret nr.295, datë 15.09.1992 i ndryshuar me ligjin nr.7461, datë 1.12.1992, me ligjin nr. 8729, datë 18.01.2001.	Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësi ndaj personave të tretë.	Ligji vendos detyrime për sigurimin e detyrueshëm dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta në rastet e aksidenteve, duke parashikuar procedura për përbushjen e këtyre detyrimeve. Parashikon gjithashtu krijimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, si dhe procedurat e funksionimit dhe aktivitetit të saj.
VKM nr.191, datë 25.03.2005.	Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës, të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë.	Në vendim përcaktohen mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë.
VKM nr.192, datë 25.03.2005.	Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.	Vendimi përcakton kriteret profesionale dhe të besueshmërisë së agjentëve në sigurime si dhe parashikon procedura për licencimin dhe rregulla për mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjentëve.
VKM nr.268, datë 28.04.2005.	Mbi përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivitet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit.	Vendimi përfaqëson kufijtë maksimalë të lejueshëm për aktivitet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit.
VKM nr.79, datë 28.01.2008, projekt i miratuar me vendim Bordi nr.4, datë 30.08.2007.	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës.	Vendimi përcakton kriteret dhe procedurat për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licencimin e aktivitetit të agjentit në sigurime.
VKM nr.96, datë 03.02.2008, projekt i miratuar me vendim Bordi nr.3, datë 18.06.2007.	Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike e matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit.	Vendimi përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën më të rëndësishme të përgjegjësisë të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre, që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit.
VKM nr.164, datë 28.01.2008, projekt i miratuar me vendim Bordi nr.3, datë 30.08.2007.	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.	Vendimi parashikon dispozita të përgjithshme, ku krahas karakteristikave të licencës, përcaktohen kufizime lidhur me aktivitetet e tjera detyruese që mund të ushtrojnë vlerësuesi, të cilat sipas projektit duhet të jenë vetëm ato që ushtrohen në pajtim me natyrën e profesionit të tij.
Udhëzimi nr.24, datë 15.11.2007.	Për administrimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.	Ky udhëzim trajton dëmet pasurore dhe jopasurore të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, vlerësimin e dëmit dhe mënyrat e afatet e likuidimit dhe kontabilizimit të dëmeve.

Udhëzim, miratuar me vendim Bordin nr.6, datë 30.08.2007.	Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime.	Ky udhëzues përcakton parimet e mbrojtjes së policëmbajtësve, përfutuesve apo palëve të treta. Në të njëjtën kohë dhe për shoqëritë e sigurimit përben një element kyç në konkurrencën mes ofruesve të sigurimit dhe përmirësimin të imazhit publik të vetë industrisë.
Urdhër i Ministrit të Financave nr. 11, datë 25.03.2005.	Për miratimin e primit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.	Ky urdhër përcakton tarifën e primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm nga mbajtësit e automjeteve për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
Urdhër i Ministrit të Financave nr. 14, datë 06.05.2005.	Mbi shitjen dhe administrimin e Policave kufitare nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.	Objekti i këtij urdhëri është prodhimi, shitja dhe administrimi i Policave të Sigurimit Kufitar, veprime të cilat i ngarkohen Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për logarit të shoqërive të sigurimit anëtare të saj.
Regullore miratuar me vendimin nr.2, datë 18.06.2007 të Bordit të AMF.	Për kriteret e risigurimit.	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshjet risigurimi nga shoqëritë e sigurimit, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Regullore miratuar me vendimin nr.3, datë 3.10.2007 të Bordit të AMF.	Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm.	Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik, përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
Regullore miratuar me vendimin nr. 4, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit.	Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekulibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrese.
Regullore miratuar me vendimin nr.5, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF.	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.
Regullore miratuar me vendimin nr.6, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF.	Objekti i kësaj rregulloreje janë rregullat e vendosura nga AMF për mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit.
Regullore miratuar me vendimin nr.7, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF, ndryshuar me vendimin e Bordit Nr.10, datë 17.12.2007.	Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit.	Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabël të jetë jo më e gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj.
Regullore miratuar me vendimin nr.8, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike.	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Regullore miratuar me vendimin nr.9, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës.	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës nga shoqëritë e sigurimit.

Rregullore miratuar me vendimin nr.13, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë.	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degë e shoqërisë së sigurimit të huaj, procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit si dhe procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr.14, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit.	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.
Udhëzim miratuar me vendimin nr.10, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për listën e dokumentave të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit	Objekti i këtij udhëzimi është listimi i të gjithë dokumentacionit të detyruar për dhënien llogari, në mënyrë periodike dhe vjetore ndaj AMF, të shoqërive të sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr.11, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore.	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjëndjes financiare të shoqërive të sigurimit, për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmsipërblimeve e përmbushjen e detyrimeve të tjera dhe përcaktimi i rregullave për dhënien e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr.12, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF.	Për përcaktimin e kriterëve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të lidhin marrëveshje risigurimi.	Ky udhëzim ka si objekt rregullimin e veprimtarisë risiguroese të shoqërive të sigurimit, që mund të risigurojë pjesë të përgjegjësisë që ka kontraktuar me të siguruarit, me shoqëritë risiguroese vendase, degë të shoqërive risiguroese të huaja të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ose shoqëri risiguroese të huaja që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.

Në Fushën e Letrave me Vlerë

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Pëshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji 8080, datë 01.03.1996, ndryshuar me ligjet 8168, datë 5.12.1996 dhe 8745, datë 22.02.2001.	Për Letrat me Vlerë.	Ligji për Letrat me Vlerë, është baza kryesore rregullative për veprimtarinë e Komisionit të Letrave me Vlerë. Objekti i ligjit është krijimi i sigurisë për investitorët e letrave me vlerë pikërisht nëpërmjet krijimit të Komisionit të Letrave me Vlerë, rregullimit të tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së subjekteve që përfshihen në tregtimin e tyre, si edhe nëpërmjet kontrollit të emetimit publik dhe tregimit të letrave me vlerë. Me anën e këtij ligji, Komisioni krijohet si një institucion me autoritet mbikëqyrës dhe licencues për tregun e letrave me vlerë dhe, me zhvillimet e këtij të fundit, merr atributet e një institucioni të pavarur.
VKM 440, datë 17.06.2001.	Për rregullat për formën dhe përmbajtjen e njoftimeve në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë.	Në këtë vendim përcaktohen rregulla në lidhje me subjektet që kanë të drejtë të bëjnë publikimet për letrat me vlerë dhe përjashtimet nga ky rregull, rregullat në lidhje me urdhrat, që mund dhe duhet të nxjerrë Komisioni në rastet kur gjykon se një publikim në letrat me vlerë është mashtroes, detyrimin për dërgim të kopjeve të publikimeve në adresë të Komisionit, si dhe sanksionet për rastet që verifikohen se vijnë në kundërshtim me këtë vendim.
VKM 441, datë 17.06.2001.	Për rregullat e drejtimit në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë.	Qëllimi i vendimit është të parashikojë një etikë, mënyrë sjellje të personave të licencuar për të vepruar në tregun e letrave me vlerë. Përcaktohen në detyrimet në raport me klientët, detyrimi për komunikim të qartë dhe të ndershëm, detyrimi për të sqaruar klientin në lidhje me risikun, detyrimi për t'i bërë klientit të njohura tarifat e përdorura, etj. Përcaktohen gjithashtu rregulla në lidhje me ekzekutimin me përparësi të urdhrave të klientit, regjistrimin e shpejtë dhe të drejtë të transaksionit të ekzekutuar, etj.

VKM 442, datë 17.06.2001.	Për kërkesat financiare dhe ato kontabël të pjesëmarrësve në tregun e letrave me vlerë.	Në vendim përcaktohen detyrimet në mbajtjen e regjistrimeve kontabël, rinovimi dhe ruajtja e tyre, detyrimi për përgatitjen e pasyprave financiare, forma dhe përmbajtja e tyre. Jepet përcaktimi "para të klientit" dhe operacionet e lidhura me to. Gjithashtu parashikohet detyrimi i personit të licencuar për të emëruar ekspertë kontabël, duke përcaktuar kompetencat e tyre dhe procedurat e emërimit dhe shkarkimit të tyre.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për Licencimin, Kuotat dhe Komisionet.	Qëllimi i rregullores është përcaktimi i procedurave të licencimit si edhe kuotat për të cilat detyrohen subjektet rast pas rasti sipas llojit të veprimtarisë për të cilën aplikojnë.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për kërkesat për burimet financiare të personave të licencuar.	Në të vendosën rregulla përsa i përket kapitalit minimal, kufirit minimal të likuiditetit, detyrimet e personave të licencuar, përkufizimet në lidhje me mjetet e aprovuara dhe mjetet likuide si dhe vlerësimi i tyre.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për detyrimin për përgatitjen e prospektit.	Nëpërmjet saj përcaktohen rregullat e zbatueshme për ofertat publike të letrave me vlerë, që janë aksione, letra me vlerë të borxhit ose garanci, duke dhënë përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm. Në të jepet forma e detyrueshme dhe përmbajtja e prospektit. Vendosen të dhënat që duhet të përbëjnë pjesën përshkuese të një prospekti, të tilla si personat përgjegjës, këshilltarët, të dhënat mbi letrat me vlerë me të cilat lidhet oferta, informacione të përgjithshme mbi emetuesin dhe kapitalin e tij, etj. Gjithashtu rregullohen në mënyrë të detajuar procedurat për regjistrimin e prospektit, vendosen afati maksimal i një oferte publike, detyrimi për raportim në Autoritetin e emetuesit pas mbylljes së ofertës dhe masat për eliminimin e parregullsive gjatë ofertës publike.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve.	Rregullorja krijon bazë ligjore dhe gjen zbatim në të gjithë ofertat për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve apo për bashkimin e shoqërive aksionere të regjistruara në Shqipëri. Objekti i saj është sigurimi i një trajtimi të drejtë dhe të barabartë të aksionerëve, që preken nga transaksionet për marrjen e paketës së aksioneve. Me anë të kësaj rregulloreje imponohen rregullat e lojës. Oferta për marrjen e paketës kontrolluese duhet të bëhet brenda kohës së përcaktuar, me qëllim që t'u jepet aksionerëve mundësia për të marrë një vendim të mirëinformuar. Publiku ka të drejtë të informohet për çdo ndryshim të rëndësishëm .
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për licencimin e rregjistrueseve të letrave me vlerë.	Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave, procedurave dhe afateve të licencimit të personave që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për të kryer veprimtari si rregjistruer të letrave me vlerë. Rregjistruesi i letrave me vlerë është personi juridik i licencuar nga Autoriteti, që ka për objekt të aktivitetit organizimin dhe administrimin e rregjistrave të letrave me vlerë.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për organizimin e provimit të aplikantëve.	Rregullorja përcakton procedurën e organizimit të provimit për tregtarin e letrave me vlerë, këshilltarin e investimeve dhe përfaqësuesit e tyre.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për licencimin e tregut të letrave me vlerë.	Rregullorja ka për objekt të saj përcaktimin e kërkesave, afateve dhe procedurave të licencimit që duhen ndjekur nga subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për të vepruar si treg letrash me vlerë. Në këtë kuadër, përcaktohet se asnjë subjekt nuk mund të zhvillojë aktivitetin si treg letrash me vlerë, nëse nuk është licencuar me parë nga Autoriteti. Tregu i letrave me vlerë (Bursa) e organizon veprimtarinë e tij mbi bazë të statutit dhe rregullave të funksionimit të tregut, të cilat i nënshtrohen miratimit nga ana e Autoritetit.
Regullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për licencimin e tregtarit të letrave me vlerë, këshilltarit të investimeve dhe përfaqësuesve të tyre.	Në rregullore parashikohen qartë aktivitetet për të cilat licencohet tregtari i letrave me vlerë këshilltari i investimeve dhe përfaqësuesit e tyre. Kriteret e licencimit zënë një pjesë të veçantë dhe të konsiderueshme të rregullores. Në to përkufizohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që aplikuesi duhet të paraqesin në mënyrë që të licencohen për veprimtari të objektit të rregullores. E drejta e Komisionit për të lëshuar apo refuzuar kërkesat e aplikuesve, gjen zbatim në procedurat që ndiqen në një proces të tillë.

Rregullore miratuar me vendimin nr.12, datë 29.01.2007 të Bordit të AMF.	Për praktikat e paligjshme të tregtimit.	Rregullorja reflekton orientimet më të fundit të KE mbi abuzimet me tregun dhe mbrojtjen ndaj tyre. Rregullorja përcakton definicionin e informacionit të brendshëm, duke përcaktuar qartë dy elementët kryesorë të tij që janë natyra e saktë dhe ndikimi në çmim. Njëpërmyjet këtij definicioni konsiderohet abuzim me tregun edhe nëse personi që ka kryer veprimin nuk ka pasur përfitim. Për emetuesin e letrave me vlerë për herë të parë vendosen detyrime të tilla si hartimi i listës së personave me akses ndaj informacionit të brendshëm, azhormimi i saj dhe transparencja e transaksioneve të kryera nga drejtorët e shoqërisë dhe personat e lidhur me to ndaj Autoritetit. Gjithashtu parashikohen masa parandaluese, të cilat lidhen me detyrimet e personave profesionalisht të angazhuar me transaksionin për denoncimin e një praktike të paligjshme dhe detyrimet e gazetarëve dhe analistëve financiarë për të bërë transparent konfliktet e interesit në artikujt dhe analizat në lidhje me letrat me vlerë.
Rregullore miratuar me vendimin nr.5, datë 07.12.2006 të Bordit të AMF, ndryshuar me vendim Bordi Nr.2, datë 30.10.2007.	Për tregun me pakicë të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.	Kjo rregullore, përcakton qartësisht mënyrën e funksionimit të tregut me pakicë të bonove të thesarit, procedurat e monitorimit dhe të transparencës me synim mbrojtjen e investitorëve që investojnë në bono thesari të Qeverisë. Ndryshimet në këtë rregullore kanë patur si qëllim përmirësimin e kuadrit rregullativ të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Ndryshimet kanë sjellë përmirësimin e mënyrës së funksionimit dhe përdorimit të sistemit GSRM nga subjektet e licencuara.

Në Fushën e Pensioneve

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullore
Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 8393, datë 02.09.1998 dhe ligjin 9181, datë 05.02.2004.	Për pensionet suplementare dhe Institutet private të pensioneve.	Objekti i këtij ligji është të rregullojë sigurimin e pensioneve private nga institutet private të pensioneve, veprimtarinë për krijimin, licencimin dhe kontrollin e tyre.
VKM nr. 908, datë 29.12.2004.	Për procedurat e licencimit dhe mbikëqyrjes së instituteve private të pensioneve.	Vendimi përcakton dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e lejes për ushtrim veprimtarie si instituta privat pensionesh, kushtet për dhënie dhe tërheqjen e lejes, si dhe procedura për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar.
Rregullore miratuar me vendimin nr.16, datë 8.02.2007 të Bordit të AMF.	Për procedurat e licencimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënie e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare.	Objekt i kësaj rregulloreje është mënyra paraqitjes së dokumentacionit për licencim, si dhe procedurën e ndjekur nga autoriteti për dhënie e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare.
Rregullore miratuar me vendimin nr.15, datë 8.02.2007 të Bordit të AMF.	Për mbikëqyrjen e instituteve private të pensioneve suplementare.	Qëllimi i kësaj rregulloreje është hartimi i programit të kontrollit të ushtruar nga AMF ndaj instituteve private të pensioneve suplementare, procedurat e kryerjes së kontrollit, përgatitja e raportit të kontrollit dhe përcaktimi i standardeve të kontrollit.
Udhëzim, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 2, datë 21.11.2007.	Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare.	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të inspektimit në subjektet financiare jo-bankare.
Udhëzim, miratuar me vendim Bordi nr.2, datë 3.10.2007.	Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit.	Ky udhëzim përmban rregullat e shpërndarjes dhe sigurisë së informacionit, duke përcaktuar procedurat të cilat sigurojnë mirëorganizimin e institucionit si dhe lehtësojnë komunikimin ndërmjet strukturave.

SHTOJCA C

Lista e institucioneve të mbikëqyrura

TREGU I SIGURIMEVE

	1. INSIG sh.a	2. SIGMA sh.a	3. SIGAL sh.a	4. ATLANTIK sh.a
Drejtor Ekzekutiv	Saimir ZEMBLAKU	Qemal DISHA	Avni PONARI	Dritan ÇELAJ
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jete + Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital shtetëror dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas.
Adresa e Selisë	Rr. "Dibrës" Nr. 91, Tiranë.	Rr. "Komuna e Parisit", Kutia Postare Nr. 1714, Tiranë.	Bul. "Zogu I", Nr.1, Kutia Postare Nr.2387, Tiranë.	Rr. "Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë.
Tel./Faks	+355 4 234 169/ 170	+355 4 258 254, +355 4 258253	+355 4 250 220	+355 4 235 088
Faqja e Internetit	www.insig.com.al	www.sigma-al.com	www.sigal.com.al	www.atlantik.com.al
Posta Elektronike	info@insig.com.al	info@sigma-al.com	info@sigal.com.al	atlantik@atlantik.com.al info@atlantik.com.al
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 03 dhe 04, dt.08.06.2000.	Vendim Nr. 01, dt. 03.02.1999.	Vendim Nr. 02, dt. 23.06.1999.	Vendim Nr. 5, dt. 13.04.2001.
	5. INTERSIG sh.a	6. ALBSIG sh.a	7. INTERALBANIAN sh.a	8. EUROSIG sh.a
Drejtor Ekzekutiv	Shpresa BRECANI	Gezim HUQJ	Bardhyl MINXHOZI	Naim HASA
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas.
Adresa e Selisë	Rr. "Barrikadave", Pall.122, Ap 1/1, Tiranë.	Rr. "Punëtorët e Rilindjes", Nr.10, Tiranë.	Rr. "Sulejman Delvina", Zayed Business Center, Kutia Postare Nr.277/1, Tiranë.	Rr. "Lek Dukagjini", Nr. 5, Tiranë.
Tel./Faks	+355 4 235 614, + 355 4 232 462	+355 4 254 761/762 /764/ 770	+355 4 229 511, +355 4 229 578	+355 4 238 899, +355 4 223 841
Faqja e Internetit	intersig@albantaonline.net	www.albsig.com.al	www.interalbanian.com	www.eurosig.al
Posta Elektronike	contact@sicred.com.al	info@albsig.com.al	ttroqe@interalbanian.com	info@eurosig.al
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 6, dt. 13.09.2001.	Vendim 10, dt. 19.07.2004.	Vendim Nr. 9, dt. 19.07.2004.	Vendim Nr. 7, dt. 8.07.2004.
	9. SICRED sh.a	10. SIGAL-LIFE sh.a		
Drejtor Ekzekutiv	Genc KOXHAJ	Edvin HOXHAJ		
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jete.	Sigurime Jete.		
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.		
Adresa e Selisë	Rr. "Sami Frashëri", Pall. 20/10, Tiranë.	Bul. "Zogu I", Nr 1, Tiranë.		
Tel./Faks	+355 4 237 549	+355 4 233 308		
Faqja e Internetit	www.sicred.com.al	www.sigal.com.al		
Posta Elektronike	contact@sicred.com.al	info@sigal.com.al		
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 9, dt. 26.07.2004.	Vendim Nr. 11, date 28.07.2004.		

TREGU I LETRAVE ME VLERË

1. BANKA E TIRANËS sh.a		2. Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve sh.a		3. TRIUMF GROUP sh.a	
Drejtor Ekzekutiv	Dimitris FRANGETIS	Enton SHAHAJ	Mirela ANGJELI		
Fusha e Aktivitetit	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë.	Rregjistruar i aksioneve të shoqërive tregtare.	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë.		
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri kryesisht me kapital shtetëror.	Shoqëri me kapital privat vendas.		
Adresa e Selisë	Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë.	Rr. "George W. Bush", Nr.13, Tiranë.	Rr. "M. Gjollesha", Kulla 2, ap.13, Tiranë.		
Tel./Faks	+355 4 269 616, +355 4 269 707	+355 4 233 442, +355 4 233 425	+355 68 20 58 275 / +355 4 256 081		
Faqja e Internetit	www.tiranabank.al				
Posta Elektronike	info@tiranabank.net	gra@abissnet.com			
Dt. e Fillim. të Licenc.	05.11.2002	05.11.2002	24.11.2003		
Dt. e Mbarim. të Licenc.	Pa afat	Pa afat	Pa afat		
4. BALLKAN GROUP-01 sh.a		5. BANKA POPULLORE sh.a		6. BURSA E TIRANËS sh.a	
Drejtor Ekzekutiv	Genci RAMAJ	Henry Maus de ROLLEY	Anila FURERAJ		
Fusha e Aktivitetit	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë.	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë.	Treg i organizuar letrash me vlerë.		
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital privat vendas.	Shoqëri me kapital privat te huaj dhe vendas.	Shoqëri me kapital shtetëror.		
Adresa e Selisë	Rr. "Reshit Çollaku", Pall. 7-katësh tek Shalvaret, shk.2/6. Tiranë.	Rr. "Donika Kastrioti", Nr.11/1, Tiranë.	Rr. "Dora D'Istria", Nr. 2, Kutia Postare 274/1, Tiranë.		
Tel./Faks	+355 4 233 537, +355 4 233 537	+355 4 272790/1, +355 4 272781	+355 4 265 058		
Faqja e Internetit		www.bpopullore.com	www.tse.com.al		
Posta Elektronike		info@bpopullore.com	tseinfo@abcom-al.com		
Dt. e Fillim. të Licenc.	24.11.2003	23.03.2005	01.07.2005		
Dt. e Mbarim. të Licenc.	Pa afat	Pa afat	01.07.2007		
7. RAIFFEISEN BANK sh.a		8. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË sh.a		9. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a	
Drejtor Ekzekutiv	Oliver J. Whittle	Lorenzo RONCARI	Sevhan PENÇAPLIGIL		
Fusha e Aktivitetit	Tregtar dhe Rregjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH.	Tregtar dhe Rregjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH.	Tregtar dhe Rregjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH.		
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri me kapital të huaj.		
Adresa e Selisë	European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë.	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë.	Bul. "Zhan D'ark", Tiranë.		
Tel./Faks	+355 4 274 910	+355 4 248 753/4/5/6/7, +355 4 220 160	+355 4 250 955, +355 4 250 956		
Faqja e Internetit	www.raiffeisen.al	www.ambankalb.com	www.bkt.com.al		

<i>Posta Elektronike</i>	<i>info@raiffeisen.al</i>	<i>americanbank@ambankalb.com</i>	<i>info@bkt.com.al</i>
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	28.09.2005	24.11.2005	21.12.2005
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat
10. ALPHA BANK - TIRANA sh.a			
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Andreas GALATOULAS	Artan SANTO	Lirim MUHARREMI
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar dhe Rregjistrues i bonove të thesant.	Tregtar dhe Rregjistrues i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH.	Tregtar i Letrave me Vlerë në Bursë dhe në Tregun me Pakicë.
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri me kapital privat vendas.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.
<i>Adresa e Selisë</i>	Bul. "Zogu I", Nr. 47/1, Tiranë.	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë.	Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers, Nr. 2, Kati i 11, Tiranë.
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 240 478, +355 4 232 102	+355 4 234 096, +355 4 258 752	+355 4 280 202
<i>Faqja e Internetit</i>		<i>www.bankacredins.com</i>	
<i>Posta Elektronike</i>		<i>info@bankacredins.com</i>	
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	13.02.2006	08.05.2006	05.04.2007
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat

FONDET E PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE

1. Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë			
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Arjan KRAJA	Kiço LOLI	Themistokli ADHAMI
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Fond Privat Pensionesh Suplementare.	Fond Privat Pensionesh Suplementare.	Fond Privat Pensionesh Suplementare.
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital privat vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital privat vendas	Shoqëri me kapital privat vendas.
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Mustafa Matohiti", P.11 katësh, kati 2, zyra 1, Tiranë.	Sheshi Skenderbej, Hotel "Tirana International", kati 14, Tiranë.	Rr. "Dervish Hima", Nr.2/1, Tiranë.
<i>Tel./Faks</i>	+ 355 4 240 207/8	+355 4 265 521, + 355 4 265 044	+ 355 4 348 000, + 355 4 363 003
<i>Faqja e Internetit</i>	<i>www.apfa.com.al</i>	<i>www.garantsig-al.com</i>	<i>www.capital.com.al</i>
<i>Posta Elektronike</i>	<i>info@apfa.com.al</i>	<i>garantsig-al@abisnet.com</i>	<i>contact@capital.com.al</i>
<i>Data e Fillimit të Aktivitetit</i>	01.01.2006	01.01.2006	01.03.2006
2. GARANTSIG Instituti Privat i Pensioneve			
3. CAPITAL Instituti Privat i Pensioneve			

SHTOJCA D

Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara

A. Marrëveshje të Nënshkruara me Organizata Brenda Vendit	Viti	Institucioni
- Fakulteti i Ekonomisë	2002	KLV (sot AMF)
- Instituti i Ekspertëve Kontabël (IEKA)	2003	KLV (sot AMF)
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	2003	AMS (sot AMF)
- Autoriteti Bankar dhe Pagesave i Kosovës	2004	AMS (sot AMF)
- Banka e Shqipërisë	2005	AMS, KLV (sot AMF)
- Autoriteti i Konkurrencës	2006	AMF
B. Marrëveshje të Nënshkruara me Institucione Homologe Jashtë Vendit		
- Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë	1999	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebecut	2000	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Italisë	2002	KLV (sot AMF)
- Agjencia e Tregut të Kpitaleve të Sllovenisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë	2003	KLV (sot AMF)
- Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Maqedonisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Malit të Zi	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë	2005	KLV (sot AMF)
C. Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorëve		
- IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë)	1998	KLV (sot AMF)
- IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve)	2001	AMS (sot AMF)
- IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve)	2006	AMF

SHTOJCA E

Tabelat statistikore

Treguesit Kryesore Makro-Ekonomikë 1997 - 2007

Treguesit e Përgjithshëm

Treguesit e Përgjithshëm	Njësia matjes	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Popullsia	000	3,075	3,055	3,054	3,061	3,074	3,094	3,111	3,127	3,142	3,159	3,166
Te punësuar gjithsej	000	1,107	1,085	1,065	1,068	921	921	927	931	932	934	939
Te papunë të regjistruar.	000	194	235	240	215	181	173	164	157	154	150	143
Papunësia	%	14.9	17.7	18.4	16.8	16.4	15.8	15.0	14.4	14.2	13.8	13.2
	mIn Lekë	353,642	417,009	480,581	532,977	590,282	628,527	694,018	752,367	822,035	899,700	979,000
	rritja (%)	0.7	17.9	15.2	10.9	10.8	6.5	10.4	8.4	9.3	9.4	8.8
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	mIn US \$	2,375	2,768	3,490	3,709	4,114	4,485	5,695	7,320	8,232	9,170	10,818
	rritja (%)	-29.3	16.6	26.1	6.3	10.9	9.0	27.0	28.5	12.5	11.4	17.9
	mIn Euro	3,270	4,020	4,595	4,749	5,047	5,047	5,893	6,619	7,310	7,310	7,921
	rritja (%)		22.9	14.3	3.3	3.3	6.3	6.3	16.8	12.3	10.4	8.3
Rritja reale e PBB-së	%	-10.9	8.6	13.2	6.5	7.1	4.3	5.8	6.2	5.6	5.0	5.8
	Lekë	115,013	136,487	157,371	174,124	192,043	203,177	223,071	240,603	261,628	284,805	309,600
	rritja (%)	0.7	18.7	15.3	10.6	10.3	5.8	9.8	7.9	8.7	8.9	8.7
	US\$	772.3	906.0	1,142.9	1,211.6	1,338.5	1,449.7	1,830.6	2,341.0	2,619.9	2,903	3,402
PBB për frymë	rritja (%)	-29.3	17.3	26.1	6.0	10.5	8.3	26.3	27.9	11.9	10.8	17.1
	Euro		1,070.8	1,313.4	1,494.8	1,535.0	1,622.2	1,884.6	2,106.7	2,314.2	2,504.8	
	rritja (%)		22.6	13.8	2.7	2.7	5.7	16.2	11.8	9.8	8.2	
Inflacioni												
Mesatar vjetor	%	32.1	20.9	0.4	0.0	3.1	5.2	2.2	2.9	2.4	2.4	2.9
Fund i periudhës	%	42.1	8.7	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1

Treguesit e Financave Pulike

TREGUESIT	Njësia matjes	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Totali i të Ardhurave	milion Leke	58,949	102,524	123,161	130,643	145,639	154,595	167,224	184,356	204,163	226,283	251,600
	rritja (%)	12.7	73.9	20.1	6.1	11.5	6.1	8.2	10.2	10.7	10.8	11.1
	% e PBB	16.7	24.6	25.6	24.5	24.7	24.6	24.1	24.5	24.8	25.2	25.6
Të Ardhurat Tatimore	milion Leke	45,579	72,576	83,566	104,112	114,294	128,948	145,388	165,974	183,816	205,514	236,114
	rritja (%)	59.2	17.4	15.1	24.6	9.8	12.8	12.7	14.2	10.7	11.8	14.8
	% e PBB	12.9	17.4	17.4	19.5	19.4	20.5	20.9	22.1	22.4	22.8	24.1
Totali i Shpenzimeve	milion leke	100,730	141,628	165,692	170,620	186,049	192,517	201,152	222,439	232,339	254,762	309,727
	rritja (%)	15.0	40.6	17.0	3.0	9.0	3.5	4.5	10.6	4.5	9.7	21.5
	% e PBB	28.5	34.0	34.5	32.0	31.5	30.6	29.0	29.6	28.3	28.3	31.6
Investimet Publike	milion Lekë	13,859	24,215	34,120	36,274	43,397	37,925	31,472	38,266	38,375	47,502	57,761
	rritja (%)	74.7	40.9	6.3	6.3	19.6	-12.6	-17.0	21.6	0.3	23.8	21.5
	% e PBB	3.9	5.8	7.1	6.8	7.4	6.0	4.5	5.1	4.7	5.3	5.9
Deficiti i Përgjithshëm	milion Lekë	-41,781	-39,104	-42,531	-39,977	-40,410	-37,922	-33,928	-38,083	-28,176	-28,479	-31,000
	% e PBB	-11.8	-9.4	-8.8	-7.5	-6.8	-6.0	-4.9	-5.1	-3.43	-3.17	-3.2
	milion Lekë	120,527	149,439	177,490	226,069	241,161	260,752	280,767	295,200	327,353	348,936	369,083
Borxhi i Brendshëm	% e PBB	34.1	35.8	36.9	42.4	40.9	41.5	40.5	39.2	39.8	38.8	37.7
	Milion \$	347.5	460.5	550.1	617.0	697.7	979.6	1,200.4	1,389.9	1,356.1	1,553.3	1,774.2
	% e PBB	14.6	16.6	15.8	16.6	17.0	21.8	21.1	19.0	16.5	16.9	16.4

Burimi: Ministria e Financave dhe INSTAT

Treguesit e Tregtisë së Jashtme

TREGUESIT	Njësia matjes	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Bilanci Tregtar	Milion \$	-534.9	-603.7	-662.8	-821.0	-1,027.0	-1,155.2	-1,336.3	-1,591.6	-1,887.0	-1,953.0	-2,943
	% e PBB	-22.5	-21.8	-19.0	-22.1	-25.0	-25.8	-23.5	-21.7	-22.9	-21.3	-27.2
Eksporti	Milion \$	158.6	208.0	275.1	255.4	304.6	330.2	447.1	603.3	652	721	1,078
	rritja (%)	-34.9	31.1	32.3	-7.2	19.3	8.4	35.4	34.9	8.1	10.6	49.5
Importi	Milion \$	693.5	811.7	937.9	1,076.4	1,331.6	1,485.4	1,783.4	2,194.9	2,539	2,674	4,021
	rritja (%)	-24.8	17.0	15.5	14.8	23.7	11.6	20.1	23.1	15.7	5.3	50.3
Bilanci i Llogarisë Korrente	Milion \$	29.2	29.3	26.9	29.0	32.4	33.1	31.3	30.0	30.8	29.2	-37.1
	% e PBB	-253.7	-65.0	-132.9	-163.1	-217.9	-420.8	-406.7	-358.2	-576.2	-770.3	-1,217.2
Investimet e Huaja Direkte	Milion \$	47.5	45.0	41.2	143.0	207.3	135.0	178.0	341.3	238.7	293.5	637.5
	% e PBB	2.0	1.6	1.2	3.9	5.0	3.0	3.1	4.7	2.9	3.2	5.9
Transfertat	Milion \$	264.4	523.9	353.0	533.0	570.5	613.2	842.0	1,109.4	1,014	1,065	1,423
	Milion \$	306.0	384.0	482.0	608.0	754.0	860.0	1,026.0	1,374.0	1,390	1,536	2,039
Rezervat	Milion \$	3.5	3.7	3.8	4.2	4.6	4.4	3.9	4.0	4.1	4.2	4.1
	Lek/US\$	148.93	150.64	137.69	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.11	90.50
Kursi i kembimit	Lek/Euro	146.96	146.96	132.58	128.47	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.07	123.60


Burimi: Ministria e Financave dhe INSTAT

Agregatët Monetarë


TREGUESIT	Njësia matjës	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Agregati M1	milion Lekë	91,667	83,729	103,004	124,041	142,926	145,902	141,987	170,075	223,657	242,391	242,676
	Në %	1.4	-8.7	23.0	20.4	15.2	2.0	2.6	19.7	31.5	8.3	0.1
Agregati M2	milion Lekë	162,221	199,264	239,662	264,497	305,302	321,622	351,291	393,282	426,499	477,373	506,138
	Në %	34.5	22.8	20.3	10.4	15.4	5.3	9.2	11.9	8.4	11.9	6.0
Agregati M3	milion Lekë	198,547	239,526	292,871	328,101	394,316	408,129	443,527	503,256	573,049	666,467	757,610
	Në %	28.5	20.6	22.3	12.0	20.1	3.5	8.6	13.4	13.8	16.3	13.6

Burimi: Banka e Shqipërisë


Produkti i Brendshëm Bruto dhe Ritmi i Rritjes (mln Lekë)




Produkti i Brendshëm Bruto dhe Ritmi i Rritjes (mln Euro)




Inflacioni



Investimet




Borxhi Publik në % të PBB-së



Burimi: Banka e Shqipërisë


BTH 3 Mujore viti 2007 (në %)

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2007			
Janar	3.96	6.32	2.92
Shkurt	4.02	6.17	2.90
Mars	4.02	5.76	2.72
Prill	3.58	5.76	1.89
Maj	3.68	5.75	1.45
Qershor	4.18	5.68	2.01
Korrik	4.01	5.81	2.11
Gusht	4.09	5.78	4.14
Shtator	4.16	5.74	4.39
Tetor	4.35	6.06	4.20
Nëntor	4.72	6.04	3.50
Dhjetor	3.10	6.32	3.10




BTH 6 Mujore viti 2007 (në %)

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2007			
Janar	4.73	7.18	2.92
Shkurt	4.73	7.07	2.90
Mars	4.64	6.7	2.72
Prill	4.47	6.98	1.89
Maj	4.55	7.2	1.45
Qershor	4.82	7.21	2.01
Korrik	4.67	7.26	2.11
Gusht	4.75	7.25	4.14
Shtator	4.79	7.27	4.39
Tetor	4.99	7.38	4.20
Nëntor	5.26	7.35	3.50
Dhjetor	5.50	7.41	3.10



BTH 12 Mujore viti 2007 (në %)

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2007			
Janar	5.59	7.87	2.92
Shkurt	5.60	7.72	2.90
Mars	5.48	7.16	2.72
Prill	5.22	7.67	1.89
Maj	5.39	7.99	1.45
Qershor	5.73	7.96	2.01
Korrik	5.56	7.99	2.11
Gusht	5.56	7.97	4.14
Shtator	5.70	7.99	4.39
Tetor	5.71	8.1	4.20
Nëntor	6.03	8.07	3.50
Dhjetor	6.33	8.26	3.10



Burimi: Banka e Shqipërisë

